

Politika për privatësinë për përdorimin e shërbimeve online me celular të Volkswagen AG (Car-Net, We Connect dhe VW Connect) dhe për mbledhjen e të dhënave për krijimin e një grupi të dhënash anonime për zhvillimin e drejtimit të automatizuar te Pjesa III

(Versioni: mars 2025 – Politika për privatësinë përditësohet rregullisht. Versionin aktual e gjeni gjithmonë online në <https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/carnet/al/sq/dataprivacy/latest/html>)

Kjo politikë për privatësinë informon rreth përpunimit të të dhënave personale në kuadër të përdorimit të shërbimeve online me celular "Car Net, We Connect, VW Connect" (në vijim këto referohen të përmbledhura te "VW Connect") në automjetet e Volkswagen AG. Ajo nuk zbatohet për përdorimin e shërbimeve online me celular tek automjetet e familjes ID. Politikën për privatësinë për përdorimin e shërbimeve online me celular tek automjetet e familjes ID. e gjeni në adresën <https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/weconnect/al/sq/dataprivacy/latest/html>.

Si kompani gjermane, Volkswagen AG është e detyruar të respektojë ligjin gjerman dhe Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 prill 2016, Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/KE (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave) ("**GDPR**"). Kjo ndodh edhe kur Volkswagen AG përpunon të dhëna personale nga persona me vendbanim të qëndrueshëm jashtë Gjermanisë. Informacionet e nevojshme sipas ligjit gjerman dhe GDPR rreth përpunimit të të dhënave të rëndësishme, i gjeni te **Pjesa I** e kësaj politike për privatësinë.

Gjithashtu, Volkswagen AG mund të jetë e detyruar të respektojë, deri në një masë të caktuar, edhe ligjet kombëtare të vendeve të tjera. Personat me vendbanim të qëndrueshëm në një nga vendet e përmendura te **Pjesa II** e kësaj politike për privatësinë do të gjejnë aty informacionet shtesë.

Përmbajtja

Pjesa I:

A. Informacione të përgjithshme për përpunimin e të dhënave personale

- I. Kontrolluesi për përpunimin e të dhënave
- II. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave
- III. Qëllimet e përpunimit të të dhënave gjatë përdorimit të shërbimeve online me celular
- IV. Krijimi i vlerësimeve për menaxhimin e kompanisë
- V. Përpunimi i të dhënave për qëllimin e raportimeve të brendshme të kompanisë (Business Reporting)
- VI. Përpunimi për qëllim reklamimi dhe komunikimi kontraktual i Volkswagen AG
- VII. Fshirja dhe korigjimi i të dhënave
- VIII. Marrësit e të dhënave

B. Të drejtat tuaja

- I. E drejta për informim
- II. E drejta e korigjimit
- III. E drejta për fshirje
- IV. E drejta për kufizimin e përpunimit
- V. E DREJTA PËR KUNDËRSHTIM
- VI. E drejta për transmetimin e të dhënave
- VII. E drejta e revokimit
- VIII. E drejta e ankimit

C. Përpunimi i të dhënave në detaje

- I. Volkswagen ID
- II. Volkswagen Ident
- III. Përpunimi i të dhënave gjatë përdorimit të shërbimeve online me celular
- IV. Portofoli i shërbimeve

Pjesa I Informacione sipas Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të dhënave

A. Informacione të përgjithshme për përpunimin e të dhënave personale

I. Kontrolluesi për përpunimin e të dhënave

Përgjegjësi për përpunimin e të dhënave personale është Volkswagen AG (më poshtë "ne" ose "neve").

Volkswagen AG mund ta kontaktoni në:

Volkswagen AG
Berliner Ring 2
38440 Wolfsburg
Gjermani
Tel.: +49 - 5361 - 9 - 0

connect-support@volkswagen.de

Numri në Regjistrin Tregtar HRB 100484 (Gjykata e Shkallës së Parë Braunschweig)

II. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave

Zyrtari ynë për mbrojtjen e të dhënave është në dispozicion si partner kontakti për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave si dhe për ushtrimin e të drejtave tuaja përkatëse (krahaso paragrafin B "Të drejtat tuaja").

Ju lutemi që t'i drejtoni kërkesat te:

Datenschutzbeauftragter der Volkswagen AG
Berliner Ring 2
38440 Wolfsburg
Gjermani
dataprivacy@volkswagen.de

Për ushtrimin e të drejtave përkatëse mund të përdoret edhe adresa e emailit info-datenschutz@volkswagen.de (Gjermani) dhe privacy@volkswagen.de (jashtë Gjermanisë) ose portali ynë i mbrojtjes së të dhënave të Volkswagen <https://www.datenschutz.volkswagen.de>.

III. Qëllimet e përpunimit të të dhënave gjatë përdorimit të shërbimeve online me celular

1. Lidhja dhe zbatimi i kontratës për shërbimet online me celular

• Lidhja e kontratës

Ne i përpunojmë të dhënat personale të klientëve tanë, si adresa e emailit, fjalëkalimi, kodi S-PIN, emri, adresa, ID e përdoruesit, numri i identifikimit të automjetit, marka e automjetit, pseudonimi, gjuha e preferuar, momenti i porosisë, (Start Timer 14 ditë), momenti i aktivizimit, datëlindja (për VW Ident) dhe të dhënat e përdorimit të IT, të cilat na janë vënë në dispozicion nga klientët tanë në lidhje me regjistrimin për shërbimet online me celular, për qëllimet e lidhjes ose zbatimit të kontratës për shërbimet online me celular (Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

Për më shumë lehtësi në përdorim dhe për garantimin e një funksionaliteti pa probleme si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të procesit të aktivizimit të shërbimeve online me celular për një automjet, vlerësojmë të dhënat e mëposhtme:

- Një identifikim anonim i përdoruesit që gjenerohet me anë të një algoritmi të anonimizuar nga kombinimi i identifikimit të përdoruesit dhe numrit të identifikimit të automjetit.
- Të dhënat e përdorimit të IT që gjenerohen gjatë procesit të aktivizimit dhe që mundësojnë nxjerrjen e konkluzioneve për procesin dhe për statusin e aktivizimit.

Përpunimi i përshkruar i të dhënave bëhet në bazë të interesave tona legjitime të klientëve tanë dhe klientëve potencialë, për t'ju ofruar produkte dhe shërbime të zhvilluara dhe më të mira (Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR).

• Përpunimi i të dhënave gjatë përdorimit të shërbimeve online me celular

Nëse e përdorni automjetin me shërbimet online me celular të aktivizuara, atëherë ne i përpunojmë të dhënat personale nga automjeti për t'ju ofruar këto shërbime, për aq kohë sa kjo është e nevojshme.

Nëse një përdorues i automjetit ka hyrë në automjet si përdorues kryesor, bashkëpërdorues apo përdorues vizitor, të dhënat e tyre personale i përpunojmë për të përmbushur detyrimet tona kontraktuale (Neni 6, paragrafi 1, germa b, GDPR). Shërbimet online me celular mund të përdoren edhe pa hyrë me një llogari në automjet. Për këtë është e nevojshme që ta kaloni automjetin në modalitet online të cilësimit. Pasi të arrihet kjo, do të përpunohen të dhënat personale të përdoruesit të automjetit në varësi të cilësimit të zgjedhur të privatësisë. Përpunimi i të dhënave bëhet për shkak të interesave tona legjitime për të vënë në dispozicion sipas kontratës shërbimet online me celular në automjet (Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR). Informacionet për cilësimit e privatësisë dhe për konceptin e përdoruesit i gjeni në paragrafin "C. Përpunimi i detajuar i të dhënave" të "III. 1. Kufizoni përpunimin e të dhënave dhe menaxhimin e shërbimeve" dhe "III. 2. Koncepti i përdoruesit".

Gjatë përdorimit, përpunohet numri i identifikimit të automjetit (VIN), adresa IP, të dhënat e kartës SIM të automjetit, si dhe një kod i brendshëm i identifikimit të klientit të Volkswagen (nëse ka). Se cilat të dhëna do të përpunohen përveç kësaj si dhe informacionet për cilësimit e privatësisë, konceptin e përdoruesit dhe rolet individuale të përdoruesit, mund t'i merrni nga paragrafi "C.

Përpunimi i detajuar i të dhënave" në "III. 1. Përpunimi i të dhënave gjatë përdorimit të shërbimeve online me celular".

Klientët që janë regjistruar me Volkswagen ID të tyre në shërbimet online, mund të hyjnë në çdo automjet me shërbime të Volkswagen AG ("Përdoruesi vizitor"), për të marrë cilësimet e personalizuara (si p.sh. cilësimet e ndenjësës). Përdoruesit vizitorë mund të regjistrohen edhe në automjete pa shërbime të aktivizuara online për celular, për të ngarkuar cilësimet e personalizuara në automjetet. Në këtë rast e përpujshëm numrin e identifikimit të automjetit ("VIN") dhe adresën IP të automjetit. Përpunimi është i nevojshëm për funksionalitetin e shërbimeve online. Ai bëhet sipas nenit 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR në bazë të interesit tonë legjitim për zbatimin e kontratës për shërbimet online me celular me përdoruesin vizitor.

Shërbimi "sistemi i thirrjes së emergjencës eCall" është i disponueshëm në automjetet, nëse nuk janë blerë shërbime online për automjetin. Përpunimi i të dhënave për ofrimin e këtij shërbimi bëhet për shkak të detyrimit ligjor dhe për mbrojtjen e interesave thelbësore (neni 6, paragrafi 1, germa c, DSVGO bashkë me nenin 5, paragrafi 1 i rregullores (EU) 2015/758 së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 29 prill 2015, për kërkesat e miratimit të tipit për instalimin e sistemit e-Call që ndodhet në bord e që bazohet në thirrjen e emergjencës 112 në automjete dhe për ndryshimin e direktivës 2007/46/EG dhe 2018/858; Neni 6 paragrafi 1 germa d e DSVGO).

Tek automjetet Up dhe eUp regjistrimi në automjetet si dhe identifikimi i përdoruesit del nga ne. Do të shihet vetëm përdoruesi kryesor i regjistruar për automjetin si person i prekur i përpunimit të të dhënave, në qoftë se personi tregon që e ka përdorur automjetin në një moment të caktuar.

• Funksionalitetet dhe shërbimet e tjera online të vetë prodhuesit/përpunimi i të dhënave në funksionimin e flotës së automjeteve

Automjeti disponon funksionalitete online tashmë që nga fabrika, pa qenë nevoja të lidhet një kontratë e posaçme, si p.sh. "Manuali dixhital i automjetit". Informacionet për përpunimin e të dhënave gjatë përdorimit online të këtyre funksioneve i gjeni te cilësimet e secilit funksion. Udhëzimet përkatëse të mbrojtjes së të dhënave mund t'i shihni në versionin e fundit të shkarkuar edhe atëherë, nëse automjeti është në modalitetin offline.

Automjeti mund të pajiset (pjesërisht kundrejt pagesës) me shërbimet online "VW Connect" dhe "VW Connect Plus", shërbime të tjera online dhe produkte dixhitale të Volkswagen AG (si p.sh. aplikacione të caktuara In-Car ose çelësa për celular) ose të jetë lidhur me sistemin e menaxhimit të flotës së automjeteve "Fleet Interface, Connect Pro". Në rastin e sistemeve të menaxhimit të flotës së automjeteve bëhet fjalë për një zgjidhje, e cila i mundëson një operatori të flotës, për të dërguar të dhëna dhe për të kontrolluar nga distanca funksionet e automjetit.

Nëse bëhet fjalë për një automjet të flotës së automjeteve, mbledhja e të dhënave nga operatori i flotës së automjeteve mund të ketë të bëjë veçanërisht me të dhënat e mëposhtme, në varësi të teknologjisë dhe pajisjes së automjetit:

- numri i identifikimit të automjetit (VIN)
- të dhënat e mirëmbajtjes (p.sh. ndërrimi i radhës i vajit)
- të dhënat e itinerarit dhe pozicionit
- niveli i mbushjes së serbatorit ose gjendja e karikimit
- dritat paralajmëruese
- etj.

Për më tepër, operatori i flotës së automjeteve mund të kufizojë, blloktojë ose kontrollojë modalitetin e cilësimeve të privatësisë.

Operatori i flotës së automjeteve vendos për përcjelljen dhe përpunimin e të dhënave me përgjegjësi individuale (sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave). Për informacionet për përpunimin e të dhënave konkrete kontaktoni operatorin tuaj të flotës së automjeteve.

2. Disponueshmëria dhe siguria teknike e shërbimeve online me celular

Si rregull, para dorëzimit të automjetit te blerësi ose përdoruesi i automjetit (ose më së shumti nëse automjeti ka një kilometrazh fillestar prej 25 km), automjeti lidhet një herë të vetme te shitësi me serverin e të dhënave të Volkswagen, në mënyrë që certifikata e softuerit të mund të aktualizohet dhe automjeti të regjistrohet në serverin e të dhënave të Volkswagen. Aty përpunohet kilometrazhi i automjetit, si dhe numri i identifikimit të automjetit (VIN). Ky proces përditësimi shërben që shërbimet online të jenë të disponueshme për aktivizim dhe që të funksionojnë shërbimet e disponueshme në automjet pa lidhjen e një kontratë si dhe "sistemi i thirrjes së emergjencës eCall" që kërkohet me ligj. Nëse automjeti ka qenë në modalitetin e privatësisë "Privatësi maksimale" para fillimit të procesit të përditësimit, automjeti do të kthehet sërish automatikisht në këtë nivel privatësie, në përfundim të këtij procesi përditësimi. Përpunimet e të dhënave kryhen për përmbushjen e detyrimeve të kontratës së blerjes për automjetin me internet, midis blerësit të automjetit dhe shitësit, si dhe për shkak të detyrimeve tona ligjore për përdorimin e "Sistemit të thirrjes së emergjencës eCall" (Neni 6, paragrafi 1, germa b dhe neni 6, paragrafi 1, germa c, DSGVO).

Për t'i ofruar shërbimet teknikisht nga momenti i aktivizimit (veçanërisht për autentifikimin e automjetit dhe për krijimin e një lidhjeje të sigurt midis automjetit, përdoruesit dhe serverit të të dhënave të Volkswagen-it), do të përpunohet numri VIN, adresa IP, të dhënat e kartës SIM të automjetit si dhe numri i identifikimit të brendshëm të klientit të Volkswagen-it. Ai do të përdoret për të identifikuar qartë përdoruesin e automjetit dhe për të verifikuar nëse ai është i autorizuar për të përdorur një shërbim të caktuar në automjet. Kjo është për të penguar aksesin në shërbime nga personat e paautorizuar. Përpunimi i të dhënave bëhet për ofrimin e shërbimeve (neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR) dhe është i nevojshëm për autentifikimin e automjetit dhe për të mundësuar një komunikim të sigurt të automjetit ose të përdoruesit përkatës të automjetit me serverin e të dhënave.

Gjithashtu, gjatë ndezjes së automjetit, ora e sistemeve të automjetit do të sinkronizohet me orën e serverit të të dhënave. Ky përpunim të dhënash bëhet për të garantuar sigurinë IT për shërbimet online me celular. Për të verifikuar vlefshmërinë e certifikatës së dërguar nga automjeti për një komunikim të sigurt, automjeti duhet të ketë të konfiguruar orën e saktë. Vetëm në këtë mënyrë mund të vendoset një komunikim i sigurt me serverin e të dhënave dhe mund të shmangen sulmet kibernetike nga palë të treta. Përpunimi i të dhënave kryhet për përmbushjen e detyrimeve të kontratës së blerjes për automjetin me lidhje interneti, midis blerësit të automjetit dhe shitësit dhe, sipas rastit, për përgatitjen e kontratës ose për zbatimin e kontratës së shërbimeve online me celular (neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

Përveç kësaj, do të krijohen dhe do të analizohen skedarët e evidencave me numrin VIN, adresën IP, vulën e kohës dhe informacionet e mundshme të gabimeve, në mënyrë që defektet, keqfunksionimet teknike dhe kërcënimet e sigurisë të mund të identifikohen dhe të shmangen para kohe. Përpunimi i të dhënave bëhet kryesisht në bazë të interesit legjitim, të integritetit, disponueshmërisë dhe ngarkueshmërisë së sistemeve të automjetit dhe për të garantuar në këtë mënyrë sigurinë e automjetit (neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR). Në rastin e një defekti të identifikuar, sipas rastit, ne përpunojmë të dhënat e kontaktit që keni regjistruar te ne, për t'ju kontaktuar nëse nevojitet.

Përpunimi i të dhënave kryhet për përmbushjen e detyrimeve të kontratës së blerjes për automjetin me lidhje interneti, midis blerësit të automjetit dhe shitësit dhe, sipas rastit, për përgatitjen e kontratës ose për zbatimin e kontratës së "VW Connect" (neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

3. Procesi i identifikimit

Para përdorimit fillestar të disa shërbimeve të caktuara online me celular, të cilat mundësojnë aksesin në automjeti dhe/ose përdorin sinjalet paralajmëruese të automjetit. si p.sh. "Mbyllja dhe hapja", duhet të kryhet një herë të vetme një proces për verifikimin e identitetit. Në këtë proces, të dhënat personale që na ka vënë në dispozicion klienti, do të krahasohen me të dhënat në dokumentin përkatës të identitetit. Do të informojmë paraprakisht për këtë proces. Përpunimi i të dhënave bëhet vetëm pasi është dhënë shprehimisht një pëlqim nga klienti sipas (nenit 6, parag. 1, germa "a" e GDPR) dhe (nenit 9, parag. 2, germa "A" e GDPR), nëse përpunohen veçanërisht kategoritë e të dhënave personale, si dhe për qëllimin e aktivizimit të shërbimeve përkatëse online me celular.

Detajet mund të merren në paragrafin "C. Përpunimi i detajuar i të dhënave" të "II. Volkswagen Ident".

4. Këshillimi dhe shërbimi i klientit (Customer-Care)

Informacionet për këshillimin në kuadër të shërbimit të klientit gjenden online te "Politika për privatësinë për përdorimin e Customer Interaction Center (CIC)". Kjo mund të hapet në adresën <https://cic-legal.volkswagen.com>.

Nëse është e nevojshme për zbatimin e kontratës për "Car-Net", "We Connect" ose "VW Connect", mund të kontaktohet me Customer Interaction Center për klientët individual. Për këtë qëllim ne i përpunojmë të dhënat e kontaktit të regjistruara te ne, për qëllimet e zbatimit të kontratës (neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

5. Këshillimi dhe shërbimi i klientit (partneri i servisit / shitësi)

Vlen vetëm për klientët në Gjermani:

Për një shërbim të orientuar ndaj klientit në kuadër të shërbimeve tona online me celular ju mund të kontaktoni partnerin tuaj Volkswagen (partnerin e servisit dhe/ose shitësin), i cili pranon në këtë kontekst shërbimin e klientit për Volkswagen AG. Për më tepër, të dhënat e mëposhtme transferohen ndër të tjera te partneri i Volkswagen dhe përpunohen nga ai si përpunues i kërkesave: Të dhënat e kontratës, mbiemri, emri, Volkswagen ID (emaili), VIN dhe të dhënat e automjetit, statusi i verifikimit, statusi i përdoruesit (përdoruesi kryesor po/jo), planifikimi i datave të servisit (shërbimi aktiv/ jo aktiv), partneri i preferuar i servisit (shërbimi i zgjedhur/jo i zgjedhur) si dhe të dhëna të tjera, të cilat na i vini në dispozicion në kuadër të kërkesës suaj. Të dhënat i përpunojmë sipas nenit 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për zbatimin e kontratës nëpërmjet shërbimeve online me celular ose – nëse nuk jeni klient – për lidhjen e një kontrate nëpërmjet përdorimit të shërbimeve online me celular.

IV. Krijimi i vlerësimeve për menaxhimin e kompanisë

Volkswagen AG përpiqet vazhdimisht për të përmirësuar ecuritë e proceseve të biznesit në kuadër të menaxhimit të kompanisë si dhe për të optimizuar kostot përkatëse. Për këtë është e nevojshme një analizë e thellë e të dhënave të analizës online, të ofertës, shitjes dhe porosisë. Për këtë arsye

Volkswagen AG i përpunon të dhënat nga sistemet e analizës online, të ofertës, shitjes dhe porosisë si dhe të dhënat nga shërbimet e lidhura me Volkswagen ID. Detajet për këtë përpunim të dhënash (p.sh. se cilat të dhëna përpunohen me sa saktësi) gjeni në politikën për privatësinë të Volkswagen ID në adresën <https://vwid.vwgroup.io/data-privacy>.

V. Përpunimi i të dhënave për qëllimin e raportimeve të brendshme të kompanisë (Business Reporting)

Në kuadër të raportimeve të brendshme të kompanisë (Business Reportings) përpunohen të dhënat për menaxhimin e modelit të biznesit të shërbimeve online me celular dhe për përmirësimin e përvojës së klientit. Këtu ne përpunojmë të dhënat, të cilat përdoren për produktet dixhitale të blera si dhe shërbimet në automjetet. Pasi vlerësohen, të dhënat vihen në dispozicion të departamenteve kompetente të Volkswagen AG vetëm brenda masës së nevojshme për qëllimin përkatës.

Për këtë përpunohen të dhënat personale të mëposhtme:

- Të dhënat personale të kontaktit dhe të identifikimit (p.sh.: ID e përdoruesit)
- Të dhënat e automjetit (p.sh. numri i identifikimit të automjetit (VIN), pajisja e automjetit, vendi i dorëzimit (importuesi))
- Të dhënat e kontratës (p.sh. lloji i klientëve (klient privat ose tregtar), ID e klientit, data e kontratës, historiku i klientit (p.sh. interesat e kontratës pa përfundim, konkluzionet, pagesat, rimbursimet, shpërblimet, paralajmërimet, anulimet), ankesat e klientëve, informacionet për produktet e blera (numri i artikullit, statusi i aktivizimit, data e aktivizimit, kohëzgjatja, vendi i zgjedhur gjatë regjistrimit, mënyra e pagesës), statusi i deklaratës së miratimit të marketingut, të dhënat e licencës, (ose licencat e blera, data e mbarimit))
- Të dhënat e përdorimit të IT (p.sh. ID e përdoruesit, informacionet për skedarët e evidencave rreth thirrjeve të shërbimit, adresat IP)
- Të dhënat e përdorimit të automjetit me kodin VIN/targat e automjetit, të cilat janë të rëndësishme në lidhje me garancinë, sigurimin, përgjegjësinë për produktin ose funksionimin e sigurt të automjetit (p.sh. vendi i dorëzimit, numri i identifikimit të automjetit, të dhënat e dorëzimit, pajisjet)

Përpunimi bëhet për këto qëllime:

- Analiza për kontrollin e shitjeve dhe përmirësimi i produktit

Ne përpunojmë të dhënat, për të kontrolluar shitjet, për të zhvilluar produktet dhe shërbimet e reja dhe për t'i përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme, duke analizuar normat e pranimit dhe indikatorët e rëndësishëm të performancës (KPIs). Analizat përkatëse përfshijnë gjurmimin e numrit të automjeteve të prodhuara, të dorëzuara dhe të regjistruara dhe licencat përkatëse të produktit si dhe llogaritjen e tarifave të regjistrimit dhe rinovimit. Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Interesi ynë legjitim ekziston në faktin, për të vlerësuar normat e pranimit të produkteve/shërbimeve të reja dhe për të vlerësuar normat e pranimit të produkteve/shërbimeve ekzistuese.

- Kontabiliteti

Për qëllimet e kontabilitetit, për identifikimin e gabimeve dhe për menaxhimin e rrezikut ne krahasojmë ofertat e Volkswagen Connect Shop me blerjet dhe faturat faktike të ofruesve të shërbimit të pagesës. Gjithashtu, si masë për kontrollin e cilësisë analizohen informacionet e licencës dhe transaksionet e E-Commerce, për të korrigjuar gabimet dhe për të minimizuar ofertat me gabime në Volkswagen Connect Shop. Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Interesi ynë legjitim ekziston në faktin, për të siguruar, që proceset e kontabilitetit të jenë pa gabime dhe të dhënat e financës të përputhen me transaksionet faktike, si dhe për të identifikuar dhe minimizuar rreziqet në lidhje me ofertat dhe blerjet me gabime.

- Pagesa e komisioneve, kompensimet në treg dhe importuesit

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të komisionit dhe kompensimit të shitësit dhe importuesit ne krijojmë raporte sipas tregut dhe shitësit me informacione për produktet e blera, kohëzgjatjen e produktit, datën e blerjes, çmimin dhe vlerën e komisionit. Më pas, të dhënat e rëndësishme ofrohen për organizimin e komisioneve të shitjes tek importuesit. Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Ne kemi një interes legjitim, për të llogaritur dhe kryer me saktësi pagesat e komisionit, për t'i vënë në dispozicion importuesve dhe shitësve të dhëna të nevojshme dhe për të menaxhuar të dhënat specifike sipas tregut, për të siguruar efikasitetin operacional.

- Monitorimi i produktit, analiza e defektit dhe kryerja e masave korrigjuese të gabimeve

Ne përpunojmë të dhënat për statusin e kontratës, duke përfshirë kodin VIN, për të identifikuar dhe eliminuar gabimet e produktit dhe për të përcaktuar nëse një klient i prekur ka të drejtë të marrë një kompensim ose për të kryer masa të tjera për eliminimin e gabimeve. Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Interesi ynë legjitim ekziston në faktin, për të mbikëqyrur sjelljen e produktit, për të analizuar dhe eliminuar gabimet si dhe për të përcaktuar nëse klientët e prekur kanë të drejtën për kompensim.

- Kompensimi i ofruesit të shërbimit që përdoret për shërbimet online me celular

Ne krahasojmë nga brenda licencat e blera në Volkswagen Connect Shop me informacionet e licencës të ruajtur në sistemet tona, në mënyrë që t'ua faturojmë shërbimeve që përdorim dhe të përpunojmë pagesat për ofruesin e shërbimit. Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Interesi ynë legjitim ekziston në faktin, për të siguruar një faturim dhe pagesë të saktë për ofruesin tonë të shërbimit, duke kontrolluar dhe llogaritur kompensimin në bazë të licencave të blera dhe shërbimeve të ofruara.

Për këtë përdoren marrësit e mëposhtëm si përpunues të kërkesave:

- Amazon Web Services Inc. (USA) – Për ofrimin e një platforme të analizës dhe të të dhënave
- Amazon Web Services EMEA SARL (Luxemburg) – Për ofrimin e një platforme të analizës dhe të të dhënave
- ADAstra GmbH (Gjermani) – Si zhvillues për Dashboards dhe Reports
- CARIAD SE (Gjermani) – Si zhvillues për Dashboards dhe Reports

- P3 Automotive GmbH (Gjermani) – Për mbështetjen e kolegëve të brendshëm për komunikimin me importuesit
- SCREEN GmbH Training-Beratung (Gjermani) – Për mbështetjen e kolegëve të brendshëm për trajnimin e importuesve në marrëdhënie me Dashboards dhe Reports
- Volkswagen Group Services GmbH (Gjermani) – Për mbështetjen e kolegëve të brendshëm për komunikimin me importuesit

Palë të tjera të treta:

- Importuesit (si përgjegjës) – Për kompensimin e shitësve dhe importuesve brenda kornizës së ndarjes së fitimit të rënë dakord me kontratë për shitjen e produkteve dixhitale

Marrësit me seli në vendet e treta:

- Përpunimi i të dhënave tuaja personale për qëllimin e raportimeve të brendshme të kompanisë kryhet edhe në një nga retë kompjuterike të Amazon Web Services EMEA SARL ("Amazon") (si përpunues i kërkesave) që operohet nga Amazon Web Services në Bashkimin Evropian. Një akses në të dhënat personale nëpërmjet Amazon Web Services, Inc. (si përpunues i kërkesave) me seli në SHBA nuk mund të përjashtohet, kështu që janë lidhur klauzola përkatëse standarde kontraktuale të BE (një kontratë e miratuar nga Komisioni Evropian që u jep të dhënave personale të njëjtën mbrojtje që ato kanë në BE për përpunimin e të dhënave në vendet joanëtare të BE).
- Klauzolat standarde kontraktuale të përdorura të BE mund t'i thërrisni nëpërmjet URL <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32021D0914>. Volkswagen AG i fshin të dhënat tuaja personale pas 10 vjetësh ose sipas kërkesave ligjore, për shembull sapo përmbushet qëllimi për të cilin janë ato mbledhur, dhe për aq kohë sa nuk ka asnjë detyrim ruajtjeje që të pengojë fshirjen e tyre.

VI. Përpunimi për qëllim reklamimi dhe komunikimi kontraktual i Volkswagen AG

Volkswagen AG përpunon vazhdimisht t'ju sigurojë gjithmonë informacione të personalizuar për ju personalisht, në mënyrë që të përmirësoni reklamimin për shitjen e produkteve dhe shërbimeve tuaja. Për më tepër, është e nevojshme një analizë e thellë e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve tona. Prandaj, nëse na keni dhënë pëlqimin tuaj për këtë, Volkswagen AG i përpunon të dhënat nga llogaria e përdoruesit Volkswagen ID ashtu si nga "VW Connect". Të dhënat tuaja i përdorim gjithashtu për t'ju kontaktuar ju në kuadër të komunikimit kontraktual (p.sh. në rastin e kontratave që skadojnë). Detajet për përpunimin e të dhënave (p.sh. se cilat të dhëna përpunohen me sa saktësi) gjeni në politikën për privatësinë të Volkswagen ID në adresën <https://vwid.vwgroup.io/data-privacy>.

VII. Fshirja dhe korigjimi i të dhënave

Sapo të dhënat personale të mos jenë më të nevojshme për qëllimin apo për qëllimet për të cilat ato janë mbledhur, ato do të fshihen nga ne, për aq kohë sa ky veprim nuk bie ndesh me detyrimet ligjore të ruajtjes së të dhënave.

Veç kësaj, klientët tanë mund t'i korigjojnë në çdo moment të dhënat që kanë vendosur te cilësimet e Volkswagen ID tuaj – nëse ata kanë krijuar një të tillë.

VIII. Marrësit e të dhënave

1. Serveri i të dhënave

Të dhënat mund të përpunohen në serverët e ofruesve të mëposhtëm të shërbimeve, në varësi të modelit dhe të pajimit, për llogarinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona:

CARIAD SE
Major-Hirst-Straße 7
38442 Wolfsburg
Gjermani

Audi AG
Auto-Union-Straße 1
85057 Ingolstadt
Gjermani

Amazon Web Services, Inc. ("AWS")
410 Terry Ave. North
Seattle WA 98109
USA

Amazon Web Services EMEA SARL
Avenue John F. Kennedy 38
1855 Luxemburg

Microsoft Ireland Operations Limited
One Microsoft Place
South County Business Park
Leopardstown
Dublin 18
D18 P521
Irlandë

2. Ofruesi i shërbimeve IT

Përveç kësaj, ne përdorim edhe ofrues të ndryshëm të shërbimeve IT, si brenda ashtu edhe jashtë BE-së. Ata na mbështetin, për shembull, me mirëmbajtjen e sistemeve tona IT dhe me asistencë teknike. Për aq kohë sa ofruesit marrin akses për shërbimet e të dhënave personale, ata i përpunojnë ato vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.

Asistenca për IT kryhet veçanërisht nga ofruesit e mëposhtëm të shërbimeve:

CARIAD SE
Major-Hirst-Straße 7
38442 Wolfsburg
Gjermani

Volkswagen Infotainment GmbH
Rensingstraße 15
44807 Bochum
Gjermani

3. Përdorues të tjerë të shërbimeve online me celular të automjetit

Disa shërbime mund t'u mundësojnë përdoruesve të automjetit që kanë rolin e përdoruesit kryesor dhe të bashkëpërdoruesit që të shohin disa të dhëna të përdorimit të automjetit (nëse është e nevojshme duke përfshirë të dhënat e vendndodhjes së automjetit) përmes fushës së tyre personale të hyrjes në shfletuesin e internetit dhe/ose aplikacionit "Volkswagen". Për të shmangur qasjen, përdoruesi i automjetit mund t'i çaktivizojë shërbimet përkatëse tek cilësimet. Përveç kësaj, përdoruesi i automjetit mund ta kufizojë këtë përpunim të dhënash të cilësimet e privatësisë. Informacionet e detajuara për cilësimet e privatësisë merren në paragrafin "C. Përpunimi i detajuar i të dhënave, III. Përpunimi i të dhënave gjatë përdorimit të shërbimeve online me celular" në pikën "1. Kufizoni përpunimin e të dhënave dhe menaxhimin e shërbimeve" dhe në shifrën 2. Koncepti i përdoruesit". Informacionet e detajuara për përpunimin e të dhënave në kuadër të secilit shërbim gjenden gjithashtu në këtë paragraf "IV. Portofoli i shërbimeve".

4. Marrësit e tjerë

Një transferim i të dhënave personale dhe/ose në lidhje me automjetin të palë të treta kryhet për aq kohë sa kjo është e nevojshme për përmirësimin e pranisë sonë online ose për përpunimin e kontratave, veçanërisht për ofrimin e shërbimeve online me celular. Informacionet lidhur me këtë transferim të dhënash të palë të treta, në kuadër të ofrimit të shërbimeve individuale online me celular, gjenden në paragrafin "C. Përpunimi i detajuar i të dhënave".

5. Marrësit me seli në vendet e treta

Volkswagen AG i transferon të dhënat personale për arsye të përmendura në këtë politikë për privatësinë edhe të marrësi dhe përpunuesi i kërkesave që e kanë selinë e tyre jashtë BE. Për garantimin e një niveli të përshtatshëm të mbrojtjes për të dhënat personale, Volkswagen AG vendos klauzolat standarde kontraktuale të BE me marrësit në vendet e treta të pasigurta. Klauzolat standarde kontraktuale të përdorura të BE mund të hapen në gjuhët e BE-së, në adresën e URL: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32021D0914y>.

Përveç kësaj – për aq kohë sa kërkohet nga ligjet e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave – merren masa të tjera mbrojtëse (p.sh. enkriptimi dhe rregulloret kontraktuale shtesë) për të garantuar një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për të dhënat personale.

6. Kërkesat ligjore për zbulimin e të dhënave

Për aq kohë sa ekzistojnë kërkesat ligjore, me kërkesë të organeve shtetërore (p.sh. kur hetohet një vepër penale) ne jemi të detyruar t'i dorëzojmë të dhënat e ruajtura nga ne, deri në masën e nevojshme. Baza ligjore për transferimin e të dhënave në organin shtetëror përkatës është detyrimi ligjor përkatës (neni 6, paragrafi 1, germa "c" e GDPR në lidhje me detyrimin ligjor përkatës).

B. Të drejtat tuaja

Ju mund të kërkoni të drejtat e mëposhtme nga Volkswagen AG në çdo kohë dhe falas.

Nëse përdorni një automjet, për të cilin janë aktivizuar shërbimet online me celular nga një përdorues kryesor, pa hyrë me kodin tuaj të Volkswagen ID, ne nuk mund t'ju identifikojmë në rastin e përdorimit të automjetit. Nëse kërkoni të drejtat tuaja si subjekt i të dhënave, ne duhet të verifikojmë identitetin tuaj dhe, nëse është e nevojshme, mund t'ju kërkojmë informacione ose shpjegime të tjera (veçanërisht informacione për periudhën ose kushtet e tjera të përdorimit të automjetit). Këto informacione shtesë mund t'i kërkojmë për të identifikuar të dhënat tuaja personale dhe për t'ju vënë ato në dispozicion. Duhet të garantojmë gjithashtu që të mos shkelen të drejtat e përdoruesve të tjerë të automjetit gjatë zbulimit të të dhënave personale.

Më shumë informacione për mbrojtjen e të drejtave tuaja gjeni në faqen e internetit <https://datenschutz.volkswagen.de/>.

I. E drejta për informim

Ju keni të drejtën të kërkonti nga ne një konfirmim, nëse do të përpunohen të dhënat personale dhe – në rast se po – cilat prej tyre dhe cilave palë të treta brenda dhe jashtë BE-së do t'u përcillen të dhënat tuaja. Keni gjithashtu të drejtën të merrni nga ne një kopje të të dhënave tuaja personale të përpunuara prej nesh.

II. E drejta e korigjimit

Ju keni të drejtën të kërkonti nga ne korigjimin e të dhënave tuaja personale nëse janë të pasakta ose të paplota.

III. E drejta për fshirje

Ju keni të drejtën të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja, nëse përmbushen kushtet e përmendura në nenin 17 të GDPR. Më pas, ju keni të drejtën, për shembull, të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja, për aq kohë sa ato nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur. Përveç kësaj, mund të kërkonti fshirjen, nëse të dhënat tuaja i përpunojmë në bazë të dhënies së pëlqimit tuaj dhe ju e revokoni këtë pëlqim.

IV. E drejta për kufizimin e përpunimit

Ju keni të drejtën të kërkonti kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja, nëse përmbushen kushtet e nenit 18 të GDPR. Ky për shembull është rasti, nëse kundërshtoni saktësinë e të dhënave tuaja. Për kohëzgjatjen e verifikimit të saktësisë së të dhënave, mund të kërkonti më pas kufizimin e përpunimit.

V. E DREJTA PËR KUNDËRSHTIM

Ju keni të drejtën të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale në rastet e mëposhtme:

- **Nëse përpunimi bëhet për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë (duke përfshirë profilizimin për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë).**
- **Nëse përpunimi (duke përfshirë profilizimin) mbështetet në bazat e mëposhtme ligjore:**
 - Përpunimi është i nevojshëm për zbatimin e një procesi që ka interes publik ose për ushtrimin e autoritetit publik që na është ngarkuar (neni 6, paragrafi 1, germa "e" e GDPR).
 - Përpunimi është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave legjitime nga ne ose palë e tretë (neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR). Në rastin e një kundërshtie të tillë, ju lutemi të ndani me ne arsyet, për të cilat kundërshtoni përpunimin e të dhënave. Ne nuk i përpunojmë më të dhënat tuaja në rastin e kundërshtimit tuaj, në qoftë se ne mund të tregojmë arsyet detyruese mbrojtëse për përpunimin, të cilat tejkalojnë interesat, të drejtat dhe liritë tuaja, ose nëse përpunimi i shërben zbatimit, ushtrimit ose mbrojtjes së pretendimeve ligjore.

VI. E drejta për transmetimin e të dhënave

Nëse përpunimi i të dhënave bazohet në dhënien e pëlqimit tuaj ose në zbatimin e një kontrate dhe nëse kjo bëhet përmes një metode përpunimi të automatizuar, atëherë ju keni të drejtën t'i merrni të dhënat tuaja në një format të strukturuar, të zakonshëm dhe të lexueshëm nga pajisjet kompjuterike, si dhe t'ia transferoni ato një organi tjetër përgjegjës. Përveç kësaj, keni të drejtën të kërkonit që të dhënat personale të transferohen direkt nga ne në një organ tjetër përgjegjës.

VII. E drejta e revokimit

Nëse përpunimi i të dhënave bazohet në dhënien e pëlqimit, ju keni të drejtën ta tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo moment pa pagesë, me efekt në të ardhmen, përmes emailit tek info-datenschutz@volkswagen.de (Gjermani); privacy@volkswagen.de (jashtë Gjermanisë), përmes portalit tonë të mbrojtjes së të dhënave të Volkswagen <https://www.datenschutz.volkswagen.de> ose duke kontaktuar në të dhënat e kontaktit tek "Të dhënat e botimit".

VIII. E drejta e ankimit

Ju keni gjithashtu të drejtë të paraqisni një ankesë pranë një autoriteti mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave ose autoriteteve të tjera kompetente për mbrojtjen e të dhënave, lidhur me përpunimin që ne u bëjmë të dhënave tuaja. Këto mund të jenë, p.sh. autoritetet për mbrojtjen e të dhënave në vendin ku banoni. Një listë me të gjitha autoritetet për mbrojtjen e të dhënave në Bashkimin Evropian dhe Zonën Ekonomike Evropiane e gjeni këtu: https://edpb.europa.eu/about-edpb/about-edpb/members_en#member-al.

C. Përpunimi i të dhënave në detaje

I. Volkswagen ID

Volkswagen ID u ofron klientëve tanë mundësinë që të regjistrohen në shërbime të shumta online të Volkswagen AG ose palëve të treta. Përpunimi i të dhënave të nevojshme bëhet në kuadër të zbatimit të kontratës (neni 6, paragrafi 1, faqe 1, germa "b" e GDPR). Volkswagen ID shërben si llogari qendrore përdoruesi, në mënyrë që klientët tanë të mund t'i menaxhojnë të dhënat e tyre personale në qendër. Për të përdorur një shërbim online me celular, është e nevojshme të krijoni një Volkswagen ID ose të hyni në një llogari përdoruesi ekzistuese të Volkswagen ID. Shërbimi online i zgjedhur nga klienti lidhet me Volkswagen ID të klientit. Kjo lidhje bëhet vetëm pas miratimit të klientit (neni 6, paragrafi 1, fq. 1, germa "a" e GDPR). Informacionet për përpunimin e të dhënave në lidhje me Volkswagen ID gjenden në politikën për privatësinë, e cila mund të thirret online në adresën <https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/IdentityKit/de/sq/volkswagen-dataPrivacy/latest/html>.

II. Volkswagen Ident

Përpara përdorimit të shërbimeve online me celular, të cilat mundësojnë aksesin për automjetin (p.sh. nëpërmjet "Mbyllja dhe hapja"), duhet kryer një verifikim i identitetit (Volkswagen Ident).

1. Procesi Volkswagen Ident me Autolent nëpërmjet portalit MyVolkswagen dhe aplikacionit Volkswagen

Autolent nga IDnow është një zgjidhje e identifikimit, e cila u mundëson klientëve të identifikohen online dhe në kohë reale. Klienti ngarkon një dokument identifikimi të lexueshëm nga pajisjet kompjuterike, si p.sh. një kartë identiteti, një pasaportë ose një patentë (në varësi të

përcaktimeve të vlefshme në vendin e klientit) dhe bën një video të shkurtër selfie. Më pas, softueri i Autoident verifikon automatikisht vërtetësinë e dokumentit dhe e krahason atë me videon, për t'u siguruar që bëhet fjalë vërtet për personin që dëshiron të identifikohet. Sapo identiteti të jetë verifikuar me sukses, klienti mund të konfirmojë online identitetin e tij dhe të përdorë shërbimet online me celular, të cilat mundësojnë p.sh. aksesin për automjetin (p.sh. nëpërmjet "Mbyllja dhe hapja").

Sipas ofruesit të autorizuar të shërbimit, për më tepër transmetohet "Volkswagen ID" (numri i brendshëm i identifikimit për caktimin unik të të dhënave të klientit).

Ky numër identifikimi pasurohet me të dhëna të tjera (p.sh. foto portret) nga ofruesi i autorizuar i shërbimit, gjatë procesit të identifikimit. Në këtë mënyrë klienti mund të informohet paraprakisht për këtë veçmas dhe duhet të japë shprehimisht miratimin, në mënyrë që të mund të përpunojmë të dhënat. Përpunimi i të dhënave bëhet në këtë rast në bazë të nenit 6, paragrafi 1, germa "a" e GDPR dhe nenit 9, paragrafi 2, germa "a" e GDPR në bazë të dhënies së pëlqimit të klientit vetëm për qëllimin e identifikimit, për të aktivizuar shërbimet online me celular, për të cilat është e nevojshme një identifikim unik. Një transmetimi i të dhënave bëhet vetëm në mënyrë të enkriptuar.

Pas përfundimit të identifikimit, mbiemri, emri, datëlindja dhe Volkswagen ID e klientit si dhe momenti i identifikimit, transmetohen nga ofruesi i shërbimit te ne, me qëllim dokumentimin e rezultatit dhe aktivizimin e shërbimit online me celular. Përveç kësaj, transmetohen edhe lloji i dokumentit, numri i dokumentit, vendi i lëshimit, data e lëshimit dhe afati i vlefshmërisë me qëllim që të dokumentohet, se me cilin dokument identifikimi është identifikuar klienti.

Ne vlerësojmë, nëse procesi Volkswagen Ident ka përfunduar me sukses apo është ndërprerë. Për këtë arsye ne e ruajmë statusin e procesit të verifikimit të një klienti.

Faqja e përparme dhe faqja e pasme e dokumentit, shenja e regjistruar e sigurisë së dokumentit të identifikimit, si dhe fotot e fytyrës ruhen në IDnow për qëllime verifikimi dhe fshihen pas maksimumi tridhjetë (30) ditësh.

Të dhënat personale ruhen në Volkswagen për aq kohë, derisa klienti ta fshijë llogarinë e tij të përdoruesit Volkswagen ID.

Informacionet e ofruesit palë e tretë:

IDnow GmbH
Auenstraße 100
80469 München
Gjermani

Ky marrës i përpunon të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe në përputhje me udhëzimet tona.

2. Procesi Volkswagen Ident tek partneri juaj i servisit të Volkswagen

Procedura Volkswagen Ident mund të kryhet në vend dhe si alternativë pranë çdo partneri servisi të Volkswagen, nëse ai e ofron këtë shërbim. Së pari, klienti duhet të regjistrohet te fusha përkatëse e hyrjes në shfletuesin e internetit, duke vendosur emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes.

Pranë partnerit tuaj të servisit të Volkswagen në vend, të dhënat e shtuara krahasohen me të dhënat e patentës së klientit. Përpunimi i të dhënave bëhet në këtë rast në bazë të nenit 6, paragrafi 1, germa "a" e GDPR dhe nenit 9, paragrafi 2, germa "a" e GDPR në bazë të pëlqimit të tij të dhënë vetëm për qëllimin e identifikimit, për të aktivizuar shërbimet online me celular, për të

cilat është e nevojshme një identifikim unik. Të dhënat e regjistruara (numri i patentës, data e lëshimit, vendi i lëshimit nëse ka, afati i vlefshmërisë) do të na dërgohen ne. Një transmetimi i të dhënave bëhet vetëm në mënyrë të enkriptuar. Te partneri i servisit të Volkswagen nuk ruhen të dhëna. Partneri i servisit të Volkswagen i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe në përputhje me udhëzimet tona.

III. Përpunimi i të dhënave gjatë përdorimit të shërbimeve online me celular

Për sa kohë që parashikohet nga ligji, është në dispozicion të përdoruesve të automjeteve eCall ("Sistemi i thirrjes së emergjencës eCall") edhe pa lidhjen e një kontrate për shërbimet online.

Për të aktivizuar shërbime të tjera online me celular në automjet, nevojiten një Volkswagen ID, një kontratë për shërbimet online me celular dhe një regjistrim si përdorues kryesor për automjetin.

Gjatë përdorimit të shërbimeve online me celular, automjeti komunikon me serverin e të dhënave të Volkswagen AG. Aty përpunohen të dhënat personale (si p.sh. numri i identifikimit të automjetit (VIN)) dhe të dhënat teknike.

Te cilësimet e privatësisë mund të kufizohet lidhja dhe si rrjedhim edhe përpunimi i të dhënave personale. Shërbimet online me celular mund të mos ofrohen më pjesërisht, për aq kohë sa përpunimi i të dhënave është i kufizuar.

1. Kufizoni përpunimin e të dhënave dhe menaxhimin e shërbimeve (privatësia e disponueshme sipas modelit dhe pajimeve)

Cilësimet e privatësisë komandojnë transmetimin e të dhënave midis automjetit dhe serverit të të dhënave të Volkswagen. Përveç kësaj, në varësi të shërbimeve të disponueshme në automjet dhe shërbimeve të aktivizuara, është e mundur që përdoruesit e tjerë të automjetit me rolin e përdoruesit kryesor dhe të bashkëpërdoruesit, të mund të shohin të dhëna të caktuara të përdorimit të automjetit (nëse është e nevojshme duke përfshirë të dhënat e vendndodhjes së automjetit). Edhe kjo – veçanërisht ndarja e të dhënave të pozicionit të automjetit – mund të kufizohet përmes cilësimeve të privatësisë në automjet.

Për këtë mund të zgjidhet një nga cilësimet e mëposhtme:

• Privatësi maksimale

Të gjitha shërbimet online me celular janë çaktivizuar, përveç "Shërbimeve të sistemit të thirrjes së emergjencës eCall" ose "Shërbimi i thirrjes së emergjencës" në rast se "Sistemi ligjor i thirrjes së emergjencës eCall" nuk është i disponueshëm.

Karta SIM lidhet me rrjetin celular vetëm nëse kryhet një thirrje emergjence për shkak të një aksidenti ose në mënyrë manuale (për detajet e përpunimit të të dhënave në këtë rast, në shifrën e mëposhtme "IV. "Portofoli i shërbimeve" në pikën "Shërbimi i thirrjes së emergjencës, Sistemi i thirrjes së emergjencës eCall").

• Asnjë vendndodhje

Përpunimi i të dhënave të vendndodhjes është i ndaluar. Mund të përpunohen edhe të dhëna të tjera, si p.sh. numri i identifikimit të automjetit (VIN).

• Përdor pozicionin tim

Shërbimet online me celular mund të përdorin pozicionin e automjetit, por jo t'ia zbulojnë përdoruesve të tjerë të automjetit (shihni për këtë cilësimin e mëtejshëm "Jep vendndodhjen").

• **Ndaj pozicionin tim**

Të gjitha shërbimet online me celular janë aktivizuar. Pozicioni i automjetit mund të shihet për përdorues të tjerë të automjetit te fusha e tyre personale e hyrjes në shfletuesin e internetit ose në aplikacionin "Volkswagen", nëse shërbimet e parashikojnë një gjë të tillë. Informacionet për konceptin e përdoruesit mund të merren në paragrafin e mëposhtëm.

• **Menaxhimi i shërbimeve**

Shërbimet mund të aktivizohet dhe të çaktivizohen nga çdo përdorues edhe në mënyrë individuale. Kjo bën të mundur që para kalimit në një tjetër nivel privatësie, të përcaktohet se cilat shërbime duhet të aktivizohen dhe të çaktivizohen në këtë nivel.

2. Koncepti i përdoruesit (i disponueshëm sipas modelit dhe pajimit)

Përdoruesit e shërbimeve online mund të marrin (në varësi të modelit dhe të pajimit) role të ndryshme (role të përdoruesit). Në varësi të rolit të përdoruesit, ka autorizime të ndryshme për përdorimin e shërbimeve online me celular dhe të automjetit:

Roli i përdoruesit "**përdorues kryesor**" është parashikuar për poseduesin ose për përdoruesin jo të autorizuar përkohësisht (marrësi i leasing, shoferi i makinës së shërbimit ose të tjerë) të automjetit. Parimisht, përdoruesi kryesor i ka të gjitha autorizimet. Për çdo automjet ka vetëm një përdorues kryesor. Nëse autorizohet një përdorues i ri kryesor për automjetin, përdoruesi kryesor i deritanishëm e humbet automatikisht rolin e tij si përdorues kryesor. Në automjet tregohet dukshëm për çdo përdorues, se kush është përdoruesi kryesor aktual dhe që kur ky e ka këtë rol të përdoruesit kryesor. Tregimi i këtij informacioni bëhet për përmbushjen e kontratës së shërbimeve online me celular (Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

Roli i përdoruesit "**bashkëpërdorues**" është parashikuar për përdoruesit që e përdorin rregullisht automjetin p.sh. anëtarët e familjes, partnerët ose miqtë e përdoruesit kryesor. Bashkëpërdoruesit e marrin statusin e tyre nga përdoruesi kryesor: bashkëpërdoruesit duhet të autorizohen nga përdoruesi kryesor për automjetin, përdoruesi kryesor mund ta fshijë bashkëpërdoruesin në çdo kohë. Nëse përfundon statusi i përdoruesit kryesor që i ka dhënë autorizimin bashkëpërdoruesit, atëherë përfundon edhe statusi i bashkëpërdoruesit.

Roli i përdoruesit "**përdorues vizitor**" është parashikuar për përdoruesin që e përdor automjetin rastësisht ose një herë. Për këtë, përdoruesi vizitor mund të regjistrohet vetë në çdo automjet që ofron shërbime. Përdoruesi vizitor ka vetëm një akses të kufizuar në shërbime të caktuara online me celular.

Përdoruesi kryesor mund të shohë pseudonimin dhe foton e profilit të bashkëpërdoruesit dhe të përdoruesit vizitor të regjistruar në automjet, në fushën personale të hyrjes në shfletuesin e internetit.

Përdoruesi kryesor ka mundësinë për të ftuar një përdorues vizitor në fushën e tij personale të hyrjes në shfletuesin e internetit për rolin e bashkëpërdoruesit. Përdoruesi vizitor mund ta pranojë ose ta refuzojë ftesën për bashkëpërdoruesin ose në fushën e tij personale të hyrjes në shfletuesin e internetit ose në aplikacionin "Volkswagen". Përpunimi i informacioneve bëhet për përmbushjen e kontratës nëpërmjet shërbimeve online me celular (Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

Këtu duhet bërë dallimi me **"vizitor anonim"**. Këtë rol e merr çdo përdorues i automjetit që nuk ka hyrë në automjet me Volkswagen ID të tij. Vizitori anonim nis çdo udhëtim në nivelin e cilësimeve të privatësisë të konfiguruar së fundmi nga vizitori anonim ("Asnjë vendndodhje", "Përdor pozicionin tim" ose "Ndaj pozicionin tim"). Në varësi të niveleve të cilësimeve të privatësisë të konfiguruar prej tij vizitori anonim ka në dispozicion shërbimet.

Disa shërbime parashikojnë që – në varësi të nivelit të cilësimeve të privatësisë të caktuar nga përdoruesi aktual i automjetit – përdoruesi kryesor dhe/ose bashkëpërdoruesi mund të shohë/in disa të dhëna të caktuara përmes aplikacionit të tyre "Volkswagen" ose në fushën e tyre personale të hyrjes në shfletuesin e internetit (si p.sh. shërbimi i statusit të automjetit). Transferimi i të dhënave të përdoruesit të tjerë ndodh në kuadër të të dhënave të përdoruesit që është identifikuar për zbatimin e kontratës (neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR) dhe në kuadër të të dhënave që lidhen me një vizitor anonim në bazë të interesave tanë legjitime, për të vënë në dispozicion sipas kontratës shërbimet në automjet (neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR).

Detajet për shërbimet mund të merren në pikën e mëposhtme "IV. Portofoli i shërbimeve".

IV. Portofoli i shërbimeve

Shërbimet online me celular që listohen në vijim janë të disponueshëm sipas modelit dhe vitit të prodhimit të automjetit, sipas pajimit dhe sipas vendit, si dhe varen nga paketat e shërbimeve të prenotuara në automjet.

Më poshtë jepet një përmbledhje e të dhënave që përpunohen në kuadër të shërbimit përkatës, e bazës ligjore të përpunimit, si dhe e marrësve përkatës të të dhënave. Marrësit e të dhënave që marrin të dhënat përmes shërbimeve, mund të gjejnë në paragrafin "A. Informacione të përgjithshme për përpunimin e të dhënave personale" nën "VIII. Marrësit e të dhënave".

Për shërbimet dhe paketat e shërbimeve të cilave ato u përkasin, do t'ju informojmë në lidhjen e mëposhtme: <http://connect.volkswagen-we.com>.

Shërbimet që përpunojnë vendndodhjen aktuale të përdoruesit të automjetit, identifikohen me një *

1. Pamja e qytetit në 3D (Guide & Inform)

Ky shërbim ofron një paraqitje të detajuar të modelit të qytetit për qytete të caktuara. Disa qytete janë instaluar paraprakisht në sistemin e navigimit të automjetit, të tjera mund të ngarkohen më vonë ose të përditësohen në varësi të seksionit të hartës së shfaqur.

Të dhënat personale: numri i identifikimit të automjetit (VIN), ID e fragmentit të hartës, ID e shtresës së hartës, versioni i fragmentit të hartës, versioni i shtresës së hartës

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

2. Oraret e nisjes (Security & Service, We Connect Plus, VW Connect Plus)

Me "Kohët e nisjes" përdoruesit e automjetit mund të përcaktojnë se kur duhet të karikohet bateria e një automjeti elektrik ose hibrid dhe nëse ky automjet duhet të klimatizohet në kohën e dëshiruar të nisjes. Të dhënat mund të vendosen dhe të shfaqen për përdoruesin kryesor dhe bashkëpërdoruesin nëpërmjet aplikacionit "Volkswagen".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), kohëmatësi i nisjes me cilësimet për karikimin, klimën dhe kohët e energjisë gjatë natës

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

3. Amazon Alexa (We Connect, VW Connect)*

Me aplikacionin In-Car "Amazon Alexa", përdoruesit e automjetit mund ta përdorin asistentin zanor Amazon Alexa në mënyrë të sigurt dhe të rehatshme në automjet. Alexa është një shërbim i Amazon EU SARL, 5 Rue Plaetis, 2338 Luxembourg, Luksemburg (Amazon); Volkswagen AG nuk i përpunon të dhënat zanore. Volkswagen AG krijon vetëm një ndërfaqe në Amazon përmes aplikacionit In-Car Amazon Alexa në automjet. Të gjitha të dhënat (si të dhënat zanore, pozicioni gjeografik, adresa IP, kodi ID i pajisjes, modeli i automjetit, tokeni i qasjes) do të dërgohen direkt nga automjeti tek Amazon. Përgjegjës për përpunimin e këtyre të dhënave personale është Amazon dhe është e vlefshme politika e privatësisë së Amazon.

4. Shërbimi i thirrjes së emergjencës, sistemi i thirrjes së emergjencës eCall (disponohet në varësi të modelit dhe pajisjes)*

Në rast se përfshihen në një aksident rrugor ose nëse identifikohet një rast emergjent mjekësor – pavarësisht nga cilësimet e zgjedhura të privatësisë – bëhet një thirrje emergjence automatike. Përmes sensorëve automjeti identifikon se kur ndodh një aksident dhe në këtë rast aktivizon shërbimin "Sistemi i thirrjes së emergjencës eCall" të parashikuar nga ligji. Nëpërmjet elementit të komandimit në konsolën e tavanit (ose në sistemin e informimit dhe argëtimit) të automjetit tuaj mund të njoftoni manualisht një gjendje emergjence në çdo moment, përmes shërbimit "Sistemi i thirrjes së emergjencës eCall" ose mund të kërkonti ndihmë për përdorues të tjerë të rrugës që ndodhen në një situatë emergjence. Në rast se aktivizohet sistemi i thirrjes së emergjencës, vendoset një lidhje zanore me shërbimet e shpëtimit, përmes së cilës – sipas rastit – mund të kontrollohen dhe të transmetohen edhe të dhëna të tjera personale (p.sh. për llojin dhe shkallën e lëndimit).

Shërbimi i thirrjes së emergjencës:

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), tipi i automjetit, koha, vendndodhja, drejtimi i udhëtimit, numri i personave në automjet, gjuha e zgjedhur e sistemit të informimit dhe argëtimit, shkalla e aksidentit, drejtimi i aksidentit (p.sh. përplasje ballore ose anësore), ngjarja shkaktare, lloji i transmisionit

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "d" e GDPR (mbrojtja e interesave me rëndësi jetike), neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (mbrojtja e interesave legjitime)

Marrës të tjerë të të dhënave: Bosch Service Solutions GmbH, Mainzer Landstraße 193, 60326 Frankfurt am Main, Gjermani. (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimit tona.)

Funksioni "Shërbimi i thirrjes së emergjencës" mund të çaktivizohet përmes menaxhimit të shërbimeve (i disponueshëm në varësi të modelit dhe të pajimit); shih paragrafin C.III.1. "Kufizoni përpunimin e të dhënave dhe menaxhimin e shërbimeve (privatësia e disponueshme sipas modelit dhe pajimeve)" nën pikën "Menaxhimi i shërbimeve". Nëse nuk ka të disponueshëm një menaxhim shërbimesh në automjet, shërbimi mund të çaktivizohet në çdo partner servisi Volkswagen të përfshirë; informacione të ngjashme gjenden në manualin e automjetit.

Sistemi i thirrjes së emergjencës eCall (thirrja e emergjencës e kërkuar nga ligji):

Në rastin e një aksidenti, vendoset një lidhje zanore me shërbimet e shpëtimit, përmes së cilës, sipas rastit, mund të shfaqen ose të transmetohen edhe të dhëna të tjera (p.sh. për llojin dhe seriozitetin e lëndimit). Edhe të dhënat e mëposhtme do t'i transferohen në mënyrë automatike dhe të drejtpërdrejtë – pa përfshirjen e serverit të të dhënave të Volkswagen – nga automjeti shërbimit të shpëtimit: numri i identifikimit të automjetit (VIN), lloji i aktivizimit, tipi i automjetit, lloji i transmisionit, koha e thirrjes së emergjencës, vendndodhja, drejtimi i udhëtimit, numri i personave në automjet, ulja e shpejtësisë gjatë aksidentit në drejtim për së gjati, ulja e shpejtësisë gjatë aksidentit në drejtim të tërthortë (në varësi të modelit). Transferimi automatik i të dhënave në shërbimin e shpëtimit bëhet në bazë të detyrimit ligjor dhe për mbrojtjen e interesave thelbësore (neni 6, paragrafi 1, germa "c" e GDPR në lidhje me rregulloren (EU) 2015/758 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 29 prill 2015, për kërkesat e miratimit të tipit për instalimin e sistemit e-Call që ndodhet në bord dhe që bazohet në thirrjen e emergjencës 112 në automjete dhe për ndryshimin e direktivës 2007/46/KE; Neni 6, paragrafi 1, germa "d" e GDPR).

Nëse automjeti ndodhet në modalitetin offline (cilësimi i privatësisë maksimale), aktivizohet "Sistemi ligjor i thirrjes së emergjencës eCall", i cili në rast emergjence vendos një thirrje të emergjencës nëpërmjet rrjetit të telefonisë celulare 2G/3G. Nëse "Sistemi ligjor i thirrjes së emergjencës eCall" nuk është në dispozicion për shkak të rrjeteve të çaktivizuara të telefonisë celulare, atëherë - pavarësisht nga cilësimi i privatësisë - aktivizohet një thirrje e emergjencës nëpërmjet "Shërbimit të thirrjes së emergjencës". Një mbyllje e plotë e "Shërbimit të thirrjes së emergjencës" të vetë prodhuesit mund të kryhet vetëm nëpërmjet mbylljes së shërbimit individual.

5. Paketat e të dhënave (Guide & Inform Premium (e disponueshme vetëm për Touareg), VW Connect Plus, VW Connect Plus)

Klientët mund të blejnë paketa interneti nga një prej kompanive tona celulare partnerëve, për përdorimin e WLAN-Hotspot dhe të shërbimeve të caktuara të transmetimit e për t'i përdorur ato në automjet. Kusht paraprak për këtë është që duhet të regjistrohen pranë kompanisë celulare që kemi ngarkuar për automjetin tuaj. Përpunimi i të dhënave bëhet së bashku me blerjen dhe përdorimin e një pakete interneti me përgjegjësinë e vetë kompanisë celulare.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), të dhënat e kartës SIM

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: Kompania celulare e përdorur për automjetin

6. Të dhënat e udhëtimit (Security & Service, We Connect, VW Connect)

Me këtë shërbim, përdoruesit kryesor ose bashkëpërdoruesit e automjetit mund të shfaqin disa "të dhëna udhëtimi" të caktuara në fushën e tyre personale të hyrjes në shfletuesin e internetit dhe në aplikacionin "Volkswagen". Në përfundim të udhëtimit, pas fikjes së kuadrit, do të dërgohen të dhënat e lartpërmendura të automjetit të Volkswagen AG dhe më pas janë të disponueshme në fushën tuaj personale të hyrjes në shfletuesin e internetit, si dhe në aplikacionin "Volkswagen".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), shpejtësia mesatare, kohëzgjatja e udhëtimit, rruga e përshkuar (vetëm distanca), konsumi i përgjithshëm mesatar

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor dhe bashkëpërdoruesin: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për çdo përdorues tjetër të automjetit: Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimit sipas kontratës për përdoruesin kryesor dhe bashkëpërdoruesin)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

7. Statusi i automjetit duke përfshirë dyert dhe ndriçimin (Security & Service, We Connect, VW Connect)

"Statusi i automjetit" i mundëson përdoruesit kryesor ose bashkëpërdoruesit, shfaqjen e të dhënave të ndryshme të statusit të automjetit në aplikacionin "Volkswagen".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), lloji i transmisionit, gjendja e karikimit të baterisë, gjendja e mbushjes me karburant, autonomia e mbetur, kilometrazhi, gjendja e dritareve, dyerve dhe kapakëve, statusi i mbylljes qendrore, statusi i dritave, vula e kohës

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor dhe bashkëpërdoruesin: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për çdo përdorues tjetër të automjetit: Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimit sipas kontratës për përdoruesin kryesor dhe bashkëpërdoruesin)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

8. Raporti i gjendjes së automjetit (Guide & Inform, Security & Service, We Connect, VW Connect)

"Raporti i gjendjes së automjetit" informon përdoruesit kryesorë ose bashkëpërdoruesit për gjendjen aktuale të automjetit. Përveç kësaj, këta përdorues mund t'i shfaqin njoftimet paralajmëruese aktuale të automjetit dhe/ose një nevojë të mundshme për servis në fushën e tyre personale të hyrjes në shfletuesin e internetit dhe në aplikacionin "Volkswagen". Në këtë shërbim shfaqet vetëm një përzgjedhje e kufizuar e të gjitha dritave paralajmëruese dhe të kontrollit nga automjeti. Vendimtare janë vetëm njoftimet paralajmëruese dhe të defekteve në automjet.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), kilometrazhi, ora dhe distanca e rrugës deri në mirëmbajtjen e ardhshme, njoftimet paralajmëruese

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor dhe bashkëpërdoruesin: neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për çdo përdorues tjetër të automjetit: neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimit në automjet, sipas kontratës për përdoruesin kryesor dhe bashkëpërdoruesin)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

9. Njoftimi i zonës (Security & Service, We Connect Plus, VW Connect Plus)*

Me "Njoftimin e zonës" përdoruesi kryesor mund të dërgojë një njoftim, nëse përdoruesi kryesor vetë, bashkëpërdoruesi ose përdoruesi vizitor (me përjashtim të vizitorit anonim) hyn ose del në një zonë të përcaktuar nga përdoruesi kryesor. Çdo përdorues i regjistruar i automjetit mund të çaktivizojë në çdo kohë "Njoftimin e zonës" përmes cilësimeve në automjet dhe në këtë mënyrë

duke shmangur që përdoruesi kryesor të mos marrë një njoftim të zonës. Protokollin e aktiviteteve për këtë shërbim përdoruesi kryesor mund ta shohë në fushën e tij personale të hyrjes në shfletuesin e internetit. Ky shërbim është i disponueshëm edhe përmes aplikacionit "Volkswagen".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), zona e përcaktuar si dhe periudha kohore, pozicioni gjeografik i automjetit gjatë udhëtimit (pozicioni gjeografik mbetet në automjet dhe nuk përcillet më tej.)

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për bashkëpërdoruesin dhe përdoruesin vizitor: Neni 6, parag. 1, germa "a" e GDPR (dhënia e pëlqimit)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka (me përjashtim të përdoruesit kryesor)

10. Njoftimi i shpejtësisë (Security & Service, We Connect Plus, VW Connect Plus)*

Nëpërmjet "Njoftimit të zonës" përdoruesi kryesor mund të informohet për faktin, nëse përdoruesi kryesor vetë, bashkëpërdoruesi ose përdoruesi vizitor (me përjashtim të vizitorit anonim) e tejkalon shpejtësinë e udhëtimit të përcaktuar nga përdoruesi kryesor. Çdo përdorues i regjistruar mund ta çaktivizojë në çdo kohë "Njoftimin e shpejtësisë" përmes cilësimeve në automjet, duke shmangur kështu që përdoruesi kryesor të marrë një njoftim të shpejtësisë. Në varësi të sistemit të informimit dhe të argëtimit, çdo përdorues mund të menaxhojë shërbimin përmes portalit myVolkswagen. Për të aktivizuar ose për të çaktivizuar funksionin, duhet që përdoruesi të regjistrohet me Volkswagen ID (VW ID) të tij në <http://myVolkswagen.net>. Më pas ai duhet të klikojë në inicialet e profilit të tij në këndin e sipërm djathtas dhe të zgjedhë fushën "Profili dhe Cilësimet". Atje, te "Rregulloni të dhënat", do të gjeni opsionin për të menaxhuar menaxhimin e pëlqimit të automjetit. Protokollin e aktiviteteve për këtë shërbim përdoruesi kryesor mund ta shohë në fushën e tij personale të hyrjes në shfletuesin e internetit. Ky shërbim është i disponueshëm edhe përmes aplikacionit "Volkswagen".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), shpejtësia e përcaktuar nga përdoruesi kryesor

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për bashkëpërdoruesin dhe përdoruesin vizitor: Neni 6, parag. 1, germa "a" e GDPR (dhënia e pëlqimit)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka (me përjashtim të përdoruesit kryesor)

11. Google Earth™ (Guide & Inform)*

Me "Google Earth™", përdoruesit e automjetit mund të zbulojnë shumë vende të reja dhe falë paraqitjes realiste të mjedisit, mund të provoni një paraqitje të re navigimi.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendndodhja, adresa IP, gjuha e zgjedhur e sistemit të navigimit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: Google Ireland Ltd., Gordon House, Barrow Street, Dublin 4, Irland

12. Boria dhe sinjalet (Security & Service, We Connect Plus, VW Connect Plus)*

Me "Boria dhe sinjalet", përdoruesi kryesor dhe bashkëpërdoruesi mund të kontrollojnë në distancë sistemin e sinjaleve të emergjencës dhe borinë e automjetit përmes aplikacionit "Volkswagen", nëse ata ndodhen në afërsi (rreth 100 metra) të automjetit si dhe të shfaqin statusin aktual të sinjalit të dritave dhe të borisë. Protokollin e aktiviteteve për këtë shërbim përdoruesi kryesor dhe çdo bashkëpërdorues mund ta shohin në fushën e tyre personale të hyrjes në shfletuesin e internetit.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendndodhja e automjetit dhe e pajisjes suaj celulare fundore

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

13. In-Car Shop/Webshop (të disponueshme në të gjitha paketat)

Me funksionin "In-Car Shop/Webshop", përdoruesi kryesor mund të blejë shërbime online me celular ose të zgjatni afatin e shërbimeve online me celular në dispozicion.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), të dhënat e kontaktit, të dhënat e kontratës, të dhënat e kartës së kreditit/të dhënat e pagesës me PayPal

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: arvato distribution GmbH, Gottlieb-Daimler-Straße 1, 33428 Harsewinkel, Gjermani; J.P. Morgan Mobility Payments Solutions S.A., 161, Rue du Kiem L-8030 Strassen, Luxemburg; Markovski Solutions, Borovo Distr., bl. 10, 1680 Sofia, Bulgarien

Marrësve të mëposhtëm u transferohen të dhënat e kartës së kreditit ose të pagesës me PayPal përmes J.P. Morgan Mobility Payments Solutions S.A.:

Concardis GmbH, Helfmann-Park 7, 65760 Eschborn, Taunus, Gjermani (për pagesën me kartë krediti); PayPal (Europe) S.à.r.l. et Cie, 22- 24 Boulevard Royal, 2449 Luxemburg, Luksemburg (kur pagesa kryhet me PayPal)

14. Thirrja informuese (Guide & Inform, Security & Service, We Connect, VW Connect)*

Për të aktivizuar "Thirrje informuese" dhe për t'u lidhur me shërbimin e klientit për automjetet e "Volkswagen AG", përdoruesit e automjetit mund të përdorin elementin komandues në panelin e tavanit. Në vendet e mëposhtme ky shërbim nuk mbështetet; këtu ka vetëm një njoftim të grupit: Shqipëri, Belgjikë, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Estoni, Finlandë, Irlandë, Letoni, Lituani, Maltë, Maqedonia e Veriut, Ukrainë.

Të dhënat personale: Numri i telefonit të kartës SIM të integruar në automjet dhe të dhënat e tjera personale që jep përdoruesi i automjetit gjatë thirrjes

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: në Gjermani, Volkswagen Group Services GmbH, Major-Hirst-Str. 11, 38442 Wolfsburg, Gjermani; jashtë Gjermanisë, kompania e autorizuar e shitjes për shtetin përkatës (Importuesi) (Marrësit i përpunojnë të dhënat vetëm për llogarinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

15. Klimatizimi (Security & Service, We Connect Plus, VW Connect Plus)

Me "klimatizimin", përdoruesi kryesor dhe bashkëpërdoruesi kanë mundësinë të rregullojnë para nisjes temperaturën e përshtatshme të mjedisit të brendshëm të automjetit elektrik ose hibrid të kondicioneri (klimatizimi në gjendje të ndaluar) dhe të (ç)aktivizojnë ngrohjen e xhamave pa qenë nevoja që të ndodhen vetë në automjet. Të dhënat mund të vendosen dhe të thirren nëpërmjet aplikacionit "Volkswagen".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), statusi dhe cilësimet e klimatizimit, statusi i ngrohjes së xhamave

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

16. Karikimi (Security & Service, We Connect Plus, VW Connect Plus)

Me funksionin "Karikimi", përdoruesi kryesor dhe bashkëpërdoruesi kanë mundësinë të komandojnë karikimin e baterive të automjetit elektrik ose hibrid, të konfigurujnë procesin e karikimit dhe të kontrollojnë statusin e karikimit. Të dhënat mund të vendosen dhe të thirren më pas nëpërmjet aplikacionit "Volkswagen".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), statusi dhe cilësimet e karikimit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

17. Çelësi për celular (VW Connect)

Me këtë shërbim, përdoruesi kryesor ka mundësinë që të instalojë një çelës dixhital të automjetit në smartfonin tuaj përmes aplikacionit "Volkswagen", ose t'ia dërgojë atë klientëve të tjerë të shërbimeve online me celular. Në fushën personale përkatëse të hyrjes në shfletuesin e internetit, klientët e shërbimeve online me celular mund të shfaqin çelësat ekzistues për celular për automjetin si dhe të fshijnë ose të riemërtojnë çelësat për celular.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), kodi ID i përdoruesit, adresa e emailit (për dhënien e një çelësi një përdoruesi tjetër), vetëm në rast ndërrimi të çelësit në automjet: tipi i çelësit, kodi ID i çelësit, gjendja e kilometrave, statusi i kartës së shërbimit, statusi i funksionit "Çelës për celular" në automjet (i aktivizuar ose i çaktivizuar); kodet ID të mjedisit të siguruar në pajisjen fundore

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: Thales DIS Deutschland GmbH, Werinherstraße Straße 81, 81541 München, Gjermani. (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimit tona.)

18. Lajme (Guide & Inform)

Ky shërbim i mundëson klientëve përcaktimin e pavarur të stacionit të lajmeve (Newsfeed) dhe ta importojnë atë në fushën e tyre personale të hyrjes në shfletuesin e internetit në automjet.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), lista e preferuar e stacioneve të dëshiruara të lajmeve (Newsfeed)

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

19. Navigimi – Përditësimi online i hartave (We Connect Plus, VW Connect Plus)*

Me këtë shërbim, materiali i hartës mund të përditësohet online drejtpërdrejt në automjet. Për këtë, automjeti analizon se cilat rajone brenda një vendi janë të rëndësishme për automjetin /përshkohen më shumë nga automjeti.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), rajonet që janë përshkuar më shumë (vetëm me përditësimin automatik); numri i versionit të të dhënave të ruajtura aktualisht në hartë

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: HERE Europe B.V., Kennedyplein 222–226, 5611 ZT Eindhoven, Nederlande; për klientët japonezë, në vend të HERE Europe B.V.: Alibaba Group AutoNavi Software Co. Ltd., 7/F Shou Kai Square, NO. 10 Fu Rong Street, Wangjing, Chaoyang District, Beijing, China. (Këta marrës i përpunojnë të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

20. Navigimi – Përlllogaritja online e itinerarit (We Connect Plus, VW Connect Plus)*

Ky shërbim llogarit itinerarin më të mirë për automjetin duke marrë parasysh gjendjen aktuale të trafikut.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendndodhja, destinacioni i vendosur, versioni i të dhënave të navigimit, vula e orës, cilësimi i kritereve të itinerarit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: Joynext GmbH, Gewerbepark Merbitz Nr. 5, 01156 Dresden, Gjermani. (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

21. Navigimi – Parkimet (We Connect Plus, VW Connect Plus)*

Shërbimi "Vendet e parkimit" kërkon vendet e përshtatshme të parkimit në afërsi të vendndodhjes aktuale të automjetit. Aplikacioni informon për çmimin, oraret e hapjes, distancat si dhe numrat e telefonit.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendndodhja

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: Parkopedia Ltd. 232 Sladepool Farm Road, Birmingham, B14 5EE, Vereinigtes Königreich; Joynext GmbH, Gewerbepark Merbitz Nr. 5, 01156 Dresden, Gjermani. (Këta marrës i përpunojnë të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

22. Navigimi: Pikat e karburantit dhe stacionet e karikimit (VW Connect Plus, VW Connect Plus)*

Ky shërbim kërkon pikat e përshtatshme të karburantit si dhe stacionet e karikimit në afërsi të vendndodhjes aktuale të automjetit. Aplikacioni tregon gjithashtu numrin total dhe vendet e lira të stacionit të karikimit. Shërbimi informon gjithashtu për çmimin, oraret e hapjes, distancat si dhe numrat e telefonit.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendndodhja

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: Joynext GmbH, Gewerbepark Merbitz Nr. 5, 01156 Dresden, Gjermani. (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

23. Alarmi online kundër vjedhjes (Security & Service, We Connect Plus, VW Connect Plus)

Përmes "Alarmit online kundër vjedhjes", përdoruesi kryesor dhe bashkëpërdoruesi mund të zgjedhin në fushën e tyre personale të hyrjes në shfletuesin e internetit ose përmes aplikacionit "Volkswagen" kanalit e informacionit (njoftim me shtyrje dhe/ose me email) dhe në këtë mënyrë të aktivizojnë shërbimin. Pas aktivizimit të shërbimit, ata do të informohen lidhur me aktivizimin e alarmit kundër vjedhjes me një njoftim Push të aplikacionit Volkswagen. Protokollin e aktiviteteve për këtë shërbim përdoruesi kryesor dhe çdo bashkëpërdorues mund ta shohin në fushën e tyre personale të hyrjes në shfletuesin e internetit.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), ID e përdoruesit, arsyeja e aktivizimit dhe koha e aktivizimit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

24. Over-the-Air-Update/ aktualizimi i sistemit online-(të gjitha paketat)

Përmes këtij shërbimi, softuerët e automjetit dhe të dhënat e sistemit të informimit dhe të argëtimit përditësohen, për shembull, për të marrë funksione të reja ose për të qenë të përgatitur për ndryshimet më të fundit të trafikut rrugor.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), versionet e softuerëve dhe të harduerëve, si dhe numrat e serisë së harduerit, gjuha e zgjedhur e sistemit të informimit dhe argëtimit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: Arvato Supply Chain Solutions SE, Reinhard-Mohn-Str. 22, 33333 Gütersloh, Gjermani; CARIAD SE, Major-Hirst-Straße 7, 38442 Wolfsburg, Gjermani (Këta marrës i përpunojnë të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

25. Kërkimi online i pikave të interesit (Guide & Inform)*

Funksioni "Kërkimi online i pikave të interesit" (tekst/gjuhë) i mundëson përdoruesit të automjetit që të kërkojë me Google çdo vend destinacioni sipas preferencave personale.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN) vendndodhja, rrezja e kërkimit, gjuha e zgjedhur në sistemin e informimit dhe argëtimit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave Google Ireland Ltd., Gordon House, Barrow Street, Dublin 4, Irland (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

26. Sistemi qendror online i ngrohjes (Security & Service, We Connect Plus, VW Connect Plus)

"Sistemi qendror online i ngrohjes" i mundëson përdoruesit kryesor dhe bashkëpërdoruesit të komandojnë ngrohjen në gjendje të ndaluar përmes aplikacionit "Volkswagen".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), kohët e nisjes, statusi dhe cilësimet e klimatizimit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

27. Sistemi qendror online i ajrimit (We Connect Plus, VW Connect Plus)

"Komandimi online i ajrimit" i mundëson përdoruesit kryesor dhe bashkëpërdoruesit të komandojnë ajrimin stacionar përmes aplikacionit "Volkswagen".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), kohët e nisjes, statusi dhe cilësimet e sistemit të ajrimit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

28. Informacione online mbi trafikun (Guide & Inform, We Connect Plus, VW Connect Plus)*

Shërbimi "Informacionet online mbi trafikun" informon rreth situatave aktuale të trafikut dhe shfaq fluksin e trafikut në hartë dhe përgjatë itinerarit të sistemit të navigimit.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendndodhja, saktësia e pozicionit, drejtimi i udhëtimit, shpejtësia, pjerrësia, vendi i dëshiruar i destinacionit, cilësimet përkatëse për informacionet mbi trafikun, lloji i eventit të identifikuar, vula e orës, versioni i aplikacionit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

29. Importi online i destinacionit / importi online i itinerarit (Guide & Inform, We Connect Plus, VW Connect Plus)

Ky shërbim i mundëson përdoruesit kryesor dhe bashkëpërdoruesit që të dërgojnë pak përpara nisjes së udhëtimit pikat individuale të interesit (PMI) të regjistruara në aplikacionin "Volkswagen" si dhe itineraret e krijuara në sistemin e navigimit të automjetit. Destinacioni i dërguar ose itinerari i dërguar do të jetë i dukshëm për përdoruesin aktual të automjetit në sistemin e navigimit, sapo automjeti të përdoret online.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), termi i kërkimit, koordinatat e seksionit të hartës, itineraret e krijuara, destinacionet (pikat e interesit) të dërguara, gjuha e zgjedhur e sistemit të informimit dhe argëtimit, adresa IP, kodi ID i përdoruesit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave Google Ireland Ltd., Gordon House, Barrow Street, Dublin 4, Irland (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

30. Thirrje në rast avarie (Security & Service, VW Connect)*

Shërbimi "Thirrje në rast avarie" mund të aktivizohet edhe në rastin e avarive (me ose pa ndezjen e një drite kontrolli), si dhe në rastin e dëmeve nga aksidentet e lehta nën pragun e aktivizimit të sistemeve penguese të fëmijëve (si jastëku i ajrit dhe tendosësi i rripit). Nëse pajisja komanduese e jastëkut të ajrit identifikon një goditje të tillë, përdoruesit të automjetit do t'i ofrohet një lidhje audio me shërbimin e thirrjes së emergjencës ose një thirrje në rast avarie, përmes sistemit të informimit dhe të argëtimit. Kështu do të transmetohen automatikisht të dhëna të caktuara, si për pajimin e automjetit, për të mbështetur punonjësit e shërbimit të thirrjeve në rast avarie, si dhe nëse nevojitet, kompaninë e rimorkimit, për të ofruar ndihmë shpejt dhe në mënyrë efikase.

Për përmirësimin e produkteve tona dhe proceseve të biznesit, të funksionalitetit të klientëve të thirrjes në rast avarie, për optimizimin e përdorimit të klientëve, si dhe me qëllim për zgjidhjen e defekteve të produkteve, ne përpunojmë të dhënat tuaja. Ne analizojmë të dhënat tuaja me qëllim përmirësimin e produktit dhe garantimin e cilësisë së thirrjes në rast avarie dhe për shmangien e ndërprerjeve ose vonesave në ecurinë e procesit të përpunimit të kërkesave. Kështu kontrollojmë, për shembull, nëse ka probleme në transferimin e të dhënave të partnerët tuaj të servisit (p.sh. të dhëna të paplota ose vonesa brenda dërgimit të të dhënave), për t'i identifikuar dhe për t'i ngarkuar para kohe. Kështu ne mund të ofrojmë servisin më të mirë të mundshëm të orientuar për klientin dhe të rrisim kënaqësinë e klientit me shërbimet dixhitale. Gjithashtu, do të përcillen të dhënat e specifikuar tek importuesi përgjegjës për vendin tuaj, për komandimin dhe përmirësimin e procesit, p.sh. për auditet e cilësisë. Të dhënat e specifikuar fshihen pas pesë vjetësh (në vendet e mëposhtme ky shërbim nuk mbështetet; këtu ka vetëm një njoftim të grupit: Shqipëri, Maltë, Ukrainë).

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), numri i telefonit i kartës SIM të integruar në automjet, titulli, mënyra e adresimit, emri, datëlindja, adresa, shteti, numri i telefonit, adresa e emailit, targa), të dhënat e automjetit (marka, kilometrazhi, autonomia e mbetur, emri i modelit, viti i modelit, ngjyra, kambio, lloji i transmisionit, viti i prodhimit, tipi i automjetit, shenjat dalluese të pajisjes), të dhënat e sigurimit (emri i kompanisë së sigurimit të raportuesit të aksidentit, numri i sigurimit të raportuesit të aksidentit, lloji i dëmit, emri i kompanisë kundërshtuese të sigurimit), të dhënat e rastit (zona e përplasjes, shkalla e përplasjes, dita e aksidentit, koha e aksidentit, shkaktari, dritat paralajmëruese, regjistrimet e memories së ngjarjes, pozicioni i automjetit, korrektësia e të dhënave të GPS, drejtimi i udhëtimit, lloji i dëmtimit, data e regjistrimit të dëmit, llogaritja paraprake e dëmit, afati i ardhshëm i servisit, servisi i fundit), nëse është e nevojshme, të dhëna të tjera personale, të cilat përdoruesi i automjetit i jep gjatë telefonatës; për përpunimin e të dhënave në kuadër të analizës: numri i identifikimit të automjetit (VIN), kategoria e nevojës për servis, data e dërgimit të regjistrimit të të dhënave të telefonatës në rast avarie, partneri i zgjedhur i servisit dhe informacionet për datën e dakordsuar; partneri përkatës i servisit transmeton gjithashtu të dhënat e mëposhtme: numrin e identifikimit të automjetit, kohën e pranimit, kohën e kontaktimit dhe kohën e përpunimit.

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor, bashkëpërdoruesin dhe përdoruesin vizitor: neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); lidhur me të dhënat e një vizitori anonim neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimeve në automjet sipas

kontratës); për përpunimin e të dhënave në kuadër të analizës: neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: përmirësimi i produkteve dhe proceseve të biznesit, funksionaliteti i klientëve të thirrjes në rast avarie; optimizimi i përdorimit të klientëve; zgjidhja e defekteve të produkteve; komandimi dhe përmirësimi i procesit në treg; rritja e kënaqësisë së klientit me shërbimet)

Marrës të tjerë të të dhënave: Një Call-Center i caktuar nga kompania përkatëse e shitjes (importuesi) për vendin përkatës, nëse është e nevojshme një partner i servisit të Volkswagen ose një kompani rimorkimi, si dhe pas miratimit kompania juaj e sigurimit. Në kuadër të analizës të dhënat transmetohen te CARIAD SE, Major-Hirst-Straße 7, 38442 Wolfsburg, Gjermani (CARIAD SE i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona).

Nëse shërbimi çaktivizohet, thirrja në rast avarie është gjithmonë në dispozicion edhe offline, prandaj transmetimi automatik i të dhënave nga automjeti në Call-Center nuk kryhet.

31. Pozicioni i parkimit (Security & Service, We Connect, VW Connect)*

"Pozicioni i parkimit" i mundëson përdoruesit kryesor dhe bashkëpërdoruesit, që të thërrasin vendndodhjen e fundit të njohur të automjetit. Ky shërbim është i disponueshëm edhe përmes aplikacionit "Volkswagen".

Të dhënat personale: numri i identifikimit të automjetit (VIN), pozicioni aktual i parkimit gjatë fikjes së automjetit (heqja e çelësit, shtypja e butonit Start/Stop), pozicioni i pajisjes fundore celulare

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor dhe bashkëpërdoruesin: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për çdo përdorues tjetër të automjetit: Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimit në automjet sipas kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

32. Personalizimi online (përmes paketave, nëse janë të disponueshme në automjetin tuaj)

Me këtë funksion, përdoruesi kryesor dhe ata vizitorë mund të ruajnë cilësimet përkatëse individuale të automjetit dhe mund t'i marrin me vete në automjete të tjera Volkswagen që janë të pajisura me shërbimet online me celular. Ruajtja e cilësimeve të automjetit në sisteme të shumta bëhet automatikisht dhe në varësi të pajisjes, që nga sedilja, pasqyrat, dritat, klima e deri tek asistenca e shoferit. Cilësimet e automjetit specifike të përdoruesit ruhen në mënyrë sinkrone në të gjitha automjetet, në të cilat një përdorues është regjistruar nëpërmjet Backend. Kjo presupozon që automjeti përkatës është online (cilësimi i privatësisë nuk është "privatësi maksimale").

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), kodi ID i përdoruesit, fjalëkalimi, S-PIN, cilësimet aktuale të privatësisë së automjetit, emri dhe mbiemri, adresa e emailit, emri i përdoruesit, roli i përdoruesit, cilësimet aktuale personale të automjetit (p.sh. cilësimet e klimës, ndenjësës, ndriçimit, pasqyrave, asistencës së automjetit), stacionet e radios/aplikacionet e përdorura së fundmi, itineraret e shpeshta, destinacionet e fundit, adresa e shtëpisë, adresa e punës, destinacionet e preferuara, kategoritë e pikave të preferuara të interesit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

33. Hartat satelitore (Guide & Inform)*

Ky shërbim i mundëson përdoruesit të automjetit shfaqjen e një harte navigimi me rezolucion të lartë me pamje satelitore. Transmetimi i të dhënave të nevojshme të ofruesit tonë të shërbimit Google, bëhet në mënyrë të tillë që ofruesi i shërbimit të mos mundë të bëjë lidhjen me përdoruesin e automjetit ose me automjetin.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vula e kohës, informacione për versionet e përdorura të softuerit, versionet e hartave ose fragmenteve të hartave të përdorura, të dhënat e pozicionit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: HERE Europe B.V., Kennedyplein 222 –226, 5611 ZT Eindhoven, Nederlande. (Marrësi i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona), Google Ireland Ltd., Gordon House, Barrow Street, Dublin 4, Irland (do të transmetohen vetëm të dhënat e pozicionit ose fragmenti i kërkuar i hartës, duke përfshirë nivelin e zmadhimit)

34. Menaxhimi i të dhënave (e disponueshme sipas modelit dhe pajimit)

Menaxhimi i shërbimeve i mundëson përdoruesve të automjetit të aktivizojnë dhe të çaktivizojnë shërbimet online dhe funksionet e disponueshme të automjetit, si dhe të marrin informacione të detajuara për paketat e prenotuara të shërbimit dhe kohëzgjatjen e tyre.

Për sa kohë që janë të pranishme në automjetin përkatës, mund të aplikohen cilësime individuale privatësie. Kështu mund të kontrollohet, se cilat të dhëna duhet të dalin nga automjeti. Për më tej, funksionet e blera dhe të aktivizuara "Upgrades" si dhe aplikacionet In-Car shfaqen në fushën përkatëse personale të hyrjes në shfletuesin e internetit. Përveç kësaj, përdoruesi i automjetit merr në aplikacion një udhëzim, për aq kohë sa përdoruesi i automjetit nuk ka në dispozicion një licencë të "VW Connect".

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), statusi i aktivizimit të shërbimeve, niveli i cilësimeve të privatësisë (në varësi modelit)

Baza ligjore: Neni 6 parag. 1 germa "b" e GDPR (për përmbushjen ose fillimin e kontratës); Neni. 6 parag. 1 germa "f" e GDPR për udhëzimin, kur nuk ka të disponueshme asnjë licencë të VW Connect. (interesat legjitime: Shënim promocional kundrejt klientëve)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

35. Planifikimi i datave të servisit (Security & Service, We Connect, VW Connect)

Për aq kohë sa është aktivizuar shërbimi "Planifikimi i datave të servisit" nga përdoruesi kryesor, në rastin e datave të nevojshme të servisit (ndërrimi i vajit, inspektimet dhe mesazhet paralajmëruese të zgjedhura nga Volkswagen AG), përdoruesi kryesor kontaktohet nga partneri i servisit të Volkswagen (ose, sipas rastit, nga një kompani shitjesh ose një Call-Center i autorizuar nga partneri i servisit të Volkswagen), nëpërmjet kanalit të komunikimit të zgjedhur prej tij (email ose telefon) me qëllimin për të caktuar një datë servisi.

Përveç kësaj, për identifikimin e gabimeve të produktit si dhe për eliminimin e mangësive statusi i kërkesave të datës për servis ritransmetohet te shërbimi i aktivizuar. Nëpërmjet ritransmetimit Volkswagen AG ka mundësinë, për të identifikuar para kohe defektet e procesit dhe shkaqet e lidhura me to.

Nëse partneri i servisit i caktuar nga përdoruesi kryesor heq dorë ose nuk menaxhon më një oficinë të autorizuar të Volkswagen dhe nëse përdoruesi kryesor nuk ka zgjedhur ende një partner tjetër servisi të Volkswagen, kompania e shitjeve përgjegjëse për vendin përkatës do ta kontaktojë në rast se nevojitet datë tjetër për servisin, në mënyrë që t'i propozohet një datë takimi me një partner të përshtatshëm servisi të Volkswagen.

Për përmirësimin e produkteve tona dhe proceseve të biznesit, të funksionalitetit të klientëve të planifikimit të datave të servisit, për optimizimin e përdorimit të klientëve, si dhe me qëllim për zgjidhjen e problemeve të produkteve, përpunojmë të dhënat e kërkesës suaj për data servisi.

Ne analizojmë të dhënat tuaja të specifikuara më parë, me qëllim përmirësimin e produktit dhe garantimin e cilësisë së kërkesës për data servisi dhe për shmangien e ndërprerjeve ose vonesave në ecurinë e procesit të përpunimit të kërkesave. Kështu kontrollojmë, për shembull, nëse ka probleme në transferimin e të dhënave të partnerit tuaj të servisit (p.sh. të dhëna të paplota ose vonesa brenda dërgimit të të dhënave), për t'i identifikuar dhe për t'i ngarkuar para kohe. Kështu mund të përmbushim sa më mirë që të jetë e mundur dëshirën e klientëve për një datë servisi dhe mund të rritet kënaqësia e klientit me shërbimet dixhitale.

Për më tepër, të dhënat e përmendura më sipër i përcillen kompanisë përgjegjëse të shitjeve për vendin përkatës (për Gjermaninë kjo është Volkswagen Deutschland GmbH & Co. KG) për kontrollin dhe përmirësimin e procesit, p.sh. për auditet e cilësisë. Të dhënat e specifikuara do të fshihen pas pesë vjetësh.

Shërbimin "Planifikimi i datave të servisit" dhe transmetimin përkatës të të dhënave sipas kërkesave të servisit, përdoruesi kryesor mund ta çaktivizojë në çdo moment përmes fushës së tij personale të hyrjes në shfletuesin e internetit ose të cilësimet e aplikacionit të tij "Volkswagen" si dhe të zgjedhë, të ndryshojë ose të fshijë kanalën e dëshiruar të komunikimit ose partnerin e preferuar të servisit të Volkswagen.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), shkaku i transmetimit të të dhënave (p.sh. një nevojë e caktuar për servis), kilometrazhi, marka, modeli, viti i prodhimit, shkronja identifikuese e motorit, shkronja identifikuese e transmisionit, inspektimi i intervalit të mirëmbajtjes, intervali i mirëmbajtjes së vajit, njoftimet paralajmëruese, mënyra e adresimit, titulli, emri/mbiemri, kanali i dëshiruar i komunikimit (me telefon/me email); për përpunimin e të dhënave në kuadër të analizës: numri i identifikimit të automjetit, kategoria e nevojës për servis, data e dërgimit të kërkesës për një datë për servis, partneri i servisit i zgjedhur dhe informacionet për datën e rënë dakord për servisin. Gjithashtu, partneri përkatës i servisit na transferon të dhënat e mëposhtme: numrin e identifikimit të automjetit, kohën e pranimit, kohën e kontaktimit dhe kohën e përfundimit.

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës), sipas rastit, neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (për ritransmetimin e statusit të kërkesës së datave për servis për identifikimin, analizën dhe eliminimin e gabimeve të produktit /mangësive, si dhe për transmetimin e të dhënave të kompania përgjegjëse e shitjeve, nëse partneri i zgjedhur i servisit, ka hequr dorë nga veprimtaria ose nuk menaxhon më një oficinë të Volkswagen; krahaso më sipër); për çdo përdorues tjetër të automjetit: neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimit në automjet sipas kontratës); për përpunimin e të dhënave në kuadër të analizës: neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: përmirësimi i produkteve dhe proceseve të biznesit, funksionalitetit të klientëve të planifikimit të datave të servisit; optimizimi i përdorimit të klientëve; zgjidhja e defekteve të produkteve; komandimi dhe përmirësimi i procesit në treg; rritja e kënaqësisë së klientit me shërbimet)

Marrës të tjerë të të dhënave: Sipas nevojës për servis, ne ia transmetojmë të dhënat partnerit të servisit të Volkswagen të zgjedhur prej përdoruesit kryesor ose një kompanie shitjesh përgjegjëse

për vendin përkatës, sipas rastit, një Call-Center i caktuar nga partneri i servisit të Volkswagen ose një kompanie shitjesh të autorizuar nga partneri i servisit i Volkswagen (në rastin e autorizimit nga partneri i servisit të Volkswagen, Call-Center ose kompania përkatëse e shitjeve i përpunon të dhënat tuaja vetëm me porosi dhe sipas udhëzimit të partnerit të servisit të Volkswagen); në kuadër të analizës, të dhënat i transmetohen CARIAD SE, (Major-Hirst-Straße 7, 38442 Wolfsburg, Gjermani) si përpunues i kërkesave. Nëse partneri i përzgjedhur i servisit ka ndërprerë veprimtarinë ose nuk operon më një ofiçinë të autorizuar të Volkswagen, Volkswagen Deutschland GmbH & Co. KG (Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani) do të veprojë si përpunuesi ynë i kërkesave.

Për aq kohë sa përdoruesi kryesor ka zgjedhur partnerët e tij të preferuar të servisit me seli në Gjermani, Britani të Madhe, Itali, Francë, Japoni, Irlandë, Çeki, Spanjë (duke përfshirë ishujt Kanarie), Belgjikë, Zvicër, Suedi, Poloni, Danimarkë, Finlandë, Norvegji, Portugali, Luksemburg, Hungari, Austri, Estoni, Letoni, Lituani, Slloveni, Rumani, dhe Bullgari, Greqi, Sllovaki, Holandë, Ukrainë, Serbi, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Islandë, Maltë ose Qipro, Volkswagen AG përdor përpunuesin e mëposhtëm të kërkesave: Volkswagen Software Asset Management (SAM) GmbH (Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani), dx.one GmbH (Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani) dhe Salesforce.com Germany GmbH (Erika-Mann-Straße 31, 80636 München, Gjermani).

Në lidhje me përdorimin e përpunuesve të kërkesave, nuk mund të përjashtohet qasja në të dhëna nga nën-përpunuesit e kërkesave me bazë jashtë BE/ZEE. Për të siguruar një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për të dhënat tuaja personale, Volkswagen AG e siguron këtë transferim të të dhënave me garanci të përshtatshme ose i detyron përpunuesit e tij ta bëjnë këtë kur është e nevojshme. Përveç kësaj – kur kërkohet nga ligjet e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave – merren masa të tjera mbrojtëse (p.sh. enkriptimi dhe rregulloret kontraktuale shtesë) për të garantuar një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për të dhënat tuaja personale. Nëse përpunuesit ose nën-përpunuesit e kërkesave me bazë në SHBA janë të certifikuar sipas kuadrit të mbrojtjes së të dhënave BE-SHBA, zbatohet vendimi i përshtatshmërisë BE-SHBA dhe SHBA-ja konsiderohet një vend i tretë i sigurt në këtë drejtim.

36. Komandimi online me zë / asistenti online i gjuhës (We Connect Plus, VW Connect Plus) (i disponueshëm në varësi të modelit dhe pajisjes)

Me shërbimet online me celular të "VW Connect Plus / We Connect Plus", krahas komandimit offline me zë në automjet, përdoruesit kryesorë, bashkëpërdoruesit dhe përdoruesit vizitorë si dhe vizitorët anonimë të automjetit kanë në dispozicion edhe komandimin online me zë / asistentin online të gjuhës (i disponueshëm vetëm në gjuhët e mëposhtme: anglisht (GB), anglisht (US), gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, çekisht, holandisht, polonisht, portugalisht, suedisht, danisht, norvegjisht (në varësi të modelit dhe pajimit).

Komandimi me zë / asistenti i gjuhës mund të aktivizohet përmes butonit Push-to-Talk në timon ose përmes një komande aktivizuese, për të formuluar më pas një kërkesë. Me anë të fjalës aktivizuese, "komandimi me zë" / "asistenti me zë" mund të përdoret edhe nga pasagjerët e automjetit. Për përdorimin e fjalës aktivizuese është një shërbim që punon në sfond në sistemin e informimit dhe të argëtimit të automjetit, i cili identifikon se kur shqiptohet fjala aktivizuese. Në raste të rralla mund të ndodhë që ky shërbim në sfond, ta identifikojë pa dashje fjalën aktivizuese.

Në momentin që aktivizohet "komandimi me zë" / "asistenti me zë" përmes butonit Push-to-Talk ose fjalës aktivizuese, ai shfaqet në ekranin e sistemit të informimit dhe argëtimit, përmes një simboli grafik.

Avantazhi i komandimit online me zë / asistentit me zë online kundrejt komandimit offline me zë / asistentit offline me zë është një identifikim zanor më i mirë në përgjithësi dhe mundësi për të komanduar përmbajtjet online me anë të komandave zanore, për shembull shërbimet Streaming

(Radio interneti), pikat e interesit për navigimin si dhe mundësi për thirrjen e informacioneve për temat si moti, lajmet, dija, sporti, statusi i udhëtimit dhe aksionet. Nëse klienti jep gjithashtu një pëlqim për përpunimin e të dhënave të vendndodhjes për komandimin online me zë / asistentin me zë online IDA, atëherë ai merr rezultate edhe më të shpejta të navigimit dhe mund të thirren informacionet për mjedisin e tij përreth (të disponueshme në varësi të modelit dhe pajisjes si dhe në varësi të gjuhës së konfiguruar të sistemit). Edhe pa dhënien e pëlqimit ose në rastin e anulimit të dhënies së pëlqimit, komandimi online me zë / asistenti online i gjuhës vazhdon të jetë i përdorshëm në masën e garantuar me kontratë.

Asistenti online me zë IDA plotësohet nëpërmjet lidhjes me ChatGPT, duke i përcjellë më tej kërkesat, të cilave asistenti online me zë IDA nuk mund t'u përgjigjet te ChatGPT. Për më tepër, ofruesi i shërbimit Cerence GmbH verifikon, nëse mund t'i përgjigjet kërkesës së gjuhës. Nëse kjo nuk ndodh, kërkesa e gjuhës përcillet më tej në formë teksti te ChatGPT. ChatGPT dërgon një përgjigje në formë teksti tek ofruesi i shërbimit Cerence GmbH dhe nga ai kthehet tek automjeti. Në rastin e dhënies së përgjigjes në automjet bëhet e qartë, nëse bëhet fjalë për një ngjarje të gjeneruar nga ChatGPT. Një përcjellje e mëtejshme e të dhënave të vendndodhjes te ChatGPT nuk ndodh, në rastin e përpunimit të kërkesës së gjuhës nëpërmjet ChatGPT.

Përveç kësaj, komandat zanore të klientit vlerësohen në lidhjen ekzistuese online, për të përmirësuar në vijim komandimin me zë dhe identifikimin zanor për të gjithë klientët. Për më tepër, ato vlerësohen në parim të anonimizuara përmes procesit të automatizuar dhe bëhen të aksesueshme vetëm në raste të veçanta dhe vetëm për qëllimet e vlerësimit, për optimizimin e identifikimit zanor të punonjësve të trajnuar të ofruesit tonë të shërbimit Cerence GmbH.

Nëse automjeti përdoret në modalitet offline, të dhënat zanore do të përpunohen vetëm në automjet. Të dhënat e vendndodhjes nuk përpunohen (komandimi offline me zë / asistenti offline i gjuhës). Funkcionaliteti online mund të çaktivizohet në çdo moment në sistemin e informimit dhe të argëtimit. Përveç kësaj, mund të çaktivizohet identifikimi i fjalës aktivizuese në sistemin e informimit dhe të argëtimit, në mënyrë që komandimi me zë / asistenti me zë të mund të përdoret vetëm përmes butonit Push-to-Talk.

Të dhënat personale në lidhjen online: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendi depozitues nga ana e sistemit ose pozicioni aktual i automjetit (nëse klienti përkatës ka dhënë gjithashtu pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të vendndodhjes për komandimin online me zë / asistentin online të gjuhës), gjuha e zgjedhur e sistemit të informimit dhe argëtimit, marka e automjetit, kodi ID i përdoruesit, kodi rajonal dhe numri i versionit të softuerit të sistemit të informimit dhe argëtimit, gjuha e folur dhe gjuha e përgjigjes (vetëm për gjuhët EN-US, EN-GB, DE, FR, ES, IT, CZ, NL, PL, PT, SE, DK, NO)

Baza ligjore: Për përdoruesin kryesor, bashkëpërdoruesin dhe përdoruesin vizitor: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për përpunimin në mënyrë opsionale të pozicionit aktual të automjetit: Neni 6, parag. 1, germa "a" e GDPR (dhënia e pëlqimit); për përdoruesit e tjerë të automjetit (p.sh. vizitori anonim) dhe pasagjerët e tjerë të automjetit pa kontratë për shërbimet online me celular: Neni 6, parag.1, germa "f" e GDPR (interesi legjitim: zbatimi i kontratës për shërbimet online me celular); vlerësimi i komandave me zë nëpërmjet ofruesit të shërbimit Volkswagen AG si dhe anonimizimi i komandave me zë për analizën e mëtejshme kryhet sipas nenit 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (interesi legjitim: përmirësimi i komandimit me zë dhe identifikimi zanor për të gjithë klientët).

Marrës të tjerë të të dhënave: e.solutions GmbH, Despag-Straße 4a, 85055 Ingolstadt, Gjermani; Cerence GmbH, Jülicher Str. 376, 52070 Aachen, Gjermani. (Këta marrës i përpunojnë të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

37. Streaming & Internet: Radio Hybrid (Guide & Inform, We Connect Plus, VW Connect Plus)*

Në kuadër të funksionit "Radio Hybrid", sistemi i informimit dhe i argëtimit identifikon stacionet e radios që mund të kapen përmes sinjaleve të transmetimit (FM dhe DAB), dhe kontrollon online nëse ka transmetime ose metadata të disponueshme për këtë stacion. Kjo u jep mundësinë përdoruesve të automjetit që të dëgjojnë stacionet përkatëse përmes transmetimit online, nëse nuk kapen dot me sinjale transmetimi.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendi ku ndodhet automjeti; stacioni i radios përmes sinjaleve të transmetimit aktual

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: e.solutions GmbH, Despach-Straße 4a, 85055 Ingolstadt, Gjermani. (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

38. Streaming & Internet: Transmetimi i mediave (We Connect Plus, VW Connect Plus)

Me funksionin "Transmetimi i mediave" mund të përdoren shërbime të ndryshme transmetimi të muzikës direkt në sistemin e informimit dhe të argëtimit në automjet, pa qenë nevoja të lidhet një smartfon apo një pajisje tjetër fundore. Për këtë së pari duhet shkarkuar dhe instaluar aplikacioni përkatës i transmetimit nga përdoruesi kryesor në dyqanin In-Car.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), kodi i autentifikimit tek ofruesit e shërbimit të transmetimit, adresa IP

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: ofruesi përkatës i shërbimit Streaming

Për përpunimin e të dhënave në kuadër të shërbimit përkatës të transmetimit, këto udhëzime për mbrojtjen e të dhënave janë të rëndësishme.

39. Streaming & Internet: Radio interneti (Guide & Inform, We Connect Plus, VW Connect Plus)*

Në kuadër të funksionit "Radio interneti", sistemi i informimit dhe i argëtimit vë në dispozicion një katalog aktual stacionesh dhe podcastesh specifike sipas gjuhës. Me anë të tij, përdoruesit e automjetit kanë mundësinë të dëgjojnë mijëra stacione dhe episode podcastesh të llojeve të ndryshme nëpërmjet transmetimit online.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), shteti i pozicionit aktual gjeografik, gjuha aktuale e sistemit, versioni i softuerit

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: e.solutions GmbH, Despach-Straße 4a, 85055 Ingolstadt, Gjermani. (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

40. Pikat e karburantit (Guide & Inform)*

"Pikat e karburantit" i ofrojnë përdoruesit të automjetit informacione për pikat e karburantit në afërsi të automjetit. Këtu shfaqen çmimet në varësi të karburantit kryesor të përdorur.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendndodhja

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: OPISNAVX, 16-18 rue du Quatre Septembre, 75002 Paris, Frankreich. (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimit tona.)

41. Mbyllja dhe hapja (Security & Service, We Connect Plus, VW Connect Plus)

Me funksionin "Mbyllja dhe hapja" përdoruesi kryesor mund të përdorë mbylljen qendrore të automjetit, edhe nëse nuk ndodhet në afërsi të drejtpërdrejtë me automjetin. Për këtë, në aplikacionin "Volkswagen" ai mund të shfaqë apo edhe të ndryshojë statusin e mbylljes së dyerve dhe të bagazhit të automjetit. Për sigurinë e tij përdoruesi kryesor duhet të përcaktojë një S-PIN, i cili duhet të vendoset para çdo procesi mbylljeje ose hapjeje. Për funksionin nevojitet kryerja paraprakisht e procedurës Volkswagen Ident nga përdoruesi kryesor.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN); kodi ID i përdoruesit; informacione për hapjen apo mbylljen e dritareve elektrike, dyerve, kapakut të hapësirës së motorit dhe derës së bagazhit, si dhe nëse automjeti është i mbyllur apo i hapur; data dhe ora e hapjes dhe mbylljes; kilometrazhi

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për historikun e hapjeve dhe mbylljeve: Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

42. Moti (Guide & Inform)*

"Moti" e pajis përdoruesin e automjetit me të dhënat aktuale të motit për vendndodhjen e tij aktuale, destinacionin ose vendet e paracaktuara. Ky funksion është i disponueshëm dhe në aplikacionin "Volkswagen". Atje shfaqet temperatura e vendndodhjes së automjetit ose e telefonit celular.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendndodhja, destinacioni, vendet e kërkuara prej përdoruesve të automjetit, gjuha e zgjedhur e sistemit të informimit dhe argëtimit, njësia matëse e preferuar

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: Vaisala GmbH, Notkestr. 11, 22607 Hamburg, Gjermani. (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimit tona.)

43. Përlllogaritja online e itinerarit (We Connect Plus, VW Connect Plus)

Funksioni i planifikuesit të itinerarit i ndihmon klientët që të planifikojnë destinacionet e ardhshme në varësi të pozicionit aktual, situatës aktuale të trafikut dhe afatet e ardhshme.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendndodhja, destinacioni i dhënë, versioni i të dhënave të navigimit, cilësimi i kriterëve të itinerarit, destinacionet e fundit, të dhënat e kalendarit, destinacionet e favorizuara

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave Google Ireland Ltd., Gordon House, Barrow Street, Dublin 4, Irlandë (transmetohen vetëm të dhënat e pozicionit) (Ky marrës i përpunon të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

44. Legal Web App

Nëpërmjet "Informacione ligjore" në sistemin e informimit dhe argëtimit mund të shihen gjithnjë tekstet ligjore aktuale, si politika për privatësinë.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), adresa IP, kodi i vendit dhe gjuha

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

45. Rekomandimet për mbushjen me karburant

Veçoria "Rekomandimet për mbushjen me karburant" të shërbimit Rekomandimet live ju rekomandon për një pikë karburanti në afërsi në rastin kur autonomia e mbetur është e pakët. Kjo kryhet nëpërmjet një Pop-Up në ekranin e sistemit të informimit dhe argëtimit, i cili për më tepër përfshin një ofertë të operatorit përkatës të pikës së karburantit (p.sh. zbritja në karburant, kafeja falas etj.), i cili bashkëpunon me Volkswagen AG. Ju mund ta shikoni për më vonë ofertën ose mund të navigoni direkt në pikën e karburantit. Së fundmi, gjatë mbërritjes në destinacionin e udhëtimit juve ju bëhet e ditur oferta nëpërmjet një Pop-Up dhe në këtë rast në pamjen e detajeve mund të ngarkoni kuponin e nevojshëm në smartfonin tuaj. Veçoria "Rekomandimet për mbushjen me karburant" mund të përdoret vetëm nëse Volkswagen AG ka akses në vendndodhjen e automjetit (pozicioni gjeografik) dhe mund të përpunojë këto të dhëna. Për më tepër, numri i pseudonimizuar i identifikimit të automjetit (VIN) përdoret, për t'i caktuar oferta automjetit tuaj. Pseudonimizimi i kodit VIN përfshin heqjen e të gjitha veçorive të identifikimit të drejtpërdrejtë personal. Do të mbahen elementët që ju identifikojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (pseudonimi). Përveç kësaj, ID juaj e përdoruesit përpunohet, për të ruajtur ofertat e shënuara për ju në Backend.

Volkswagen AG i fshin të dhënat personale pas tre muajsh ose sipas kërkesave ligjore, për shembull sapo përmbohet qëllimi për të cilin janë ato mbledhur, dhe për aq kohë sa nuk ka asnjë detyrim ruajtjeje që të pengojë fshirjen e tyre.

Kjo veçori do të jetë e disponueshme në tregjet e mëposhtme gjatë vitit 2025: Ukrainë, Francë, Itali, Spanjë, Suedi, Danimarkë, Norvegji, Finlandë, Belgjikë, Holandë, Luksemburg, Austri, Zvicër.

Të dhënat personale: kodi VIN i pseudonimizuar, ID e përdoruesit, të dhënat bazë të automjetit, pozicioni gjeografik, mënyra e klikimit dhe përdorimit, vula kohore

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: MongoDB Building 2, Number 1 Ballsbridge Shellbourne Road Ballsbridge, D04 Y3X9 Dublin, Irlandë; New Relic Germany GmbH, Neuturmstraße 5, 80331 München, Gjermani (Këta marrës i përpunojnë të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

Analizat dhe matjet për ofrimin e shërbimit

Për qëllime të një ofrimi të qëndrueshëm të shërbimit dhe për identifikimin dhe eliminimin e parregullsive të mundshme në funksionet e shërbimit kryhet një monitorim i vazhdueshëm i disponueshmërisë së shërbimit, duke regjistruar dhe përpunuar pikat individuale të të dhënave përgjatë përdorimit të servisit. Kjo gjë është e mundur vetëm nëse kodi VIN i pseudonimizuar kërkohet si identifikues. Për të garantuar gjurmueshmërinë dhe analizën e gabimeve në rast të pyetjeve të klientëve kur ka defekte teknike, regjistrohet gjithashtu edhe ID e përdoruesit. Për më tepër, ne përpunojmë informacionet nëpërmjet shfaqjes së reklamave si dhe ndërveprimit të përdoruesit me reklamën, në mënyrë që të jemi në gjendje për të përcaktuar, nëse një reklamë i ka pëlqyer përdoruesit dhe mbi këtë bazë të vazhdojmë të marrim reklama nga partnerët reklamues për ofrimin e shërbimit.

Volkswagen AG i fshin të dhënat personale pas tre muajsh ose sipas kërkesave ligjore, për shembull sapo përmbushet qëllimi për të cilin janë ato mbledhur, dhe për aq kohë sa nuk ka asnjë detyrim ruajtjeje që të pengojë fshirjen e tyre.

Të dhënat personale: kodi VIN i pseudonimizuar, ID e përdoruesit, të dhënat bazë të automjetit, pozicioni gjeografik, mënyra e klikimit dhe përdorimit, vula kohore

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: MongoDB Building 2, Number 1 Ballsbridge Shellbourne Road Ballsbridge, D04 Y3X9 Dublin, Irlandë; New Relic Germany GmbH, Neuturmstraße 5, 80331 München, Gjermani (Këta marrës i përpunojnë të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

Analiza e performancës

Në bazë të të dhënave të mbledhura për ofrimin e shërbimit në kuadër të raporteve mujore kryhen analiza të ndryshme të performancës, të cilat përdoren nga Volkswagen AG për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit.

Volkswagen AG i fshin të dhënat personale pas trembëdhjetë muajsh ose sipas kërkesave ligjore, për shembull sapo përmbushet qëllimi për të cilin ato janë mbledhur, dhe për aq kohë sa nuk ka asnjë detyrim ruajtjeje që të pengojë fshirjen e tyre.

Të dhënat personale: kodi VIN i pseudonimizuar, ID e përdoruesit, të dhënat bazë të automjetit, pozicioni gjeografik, mënyra e klikimit dhe përdorimit, vula kohore

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (Volkswagen AG ka një interes legjitim, për të përpunuar të dhënat personale të përmendura më parë, për të përmirësuar vazhdimisht shërbimin Rekomandimet live.)

Marrës të tjerë të të dhënave: MongoDB Building 2, Number 1 Ballsbridge Shellbourne Road Ballsbridge, D04 Y3X9 Dublin, Irlandë; New Relic Germany GmbH, Neuturmstraße 5, 80331 München, Gjermani (Këta marrës i përpunojnë të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

Pjesa II

I. Shqipëria

Përveç bazes ligjore të përshkruara në Pjesën I, bazat ligjore për përpunimin e të dhënave personale sipas ligjit të Shqipërisë është një pëlqim i dhënë nga subjektet e të dhënave. Pëlqimi i subjekteve të të dhënave jepet ose duke u regjistruar për shërbimet në internet celular, pasi të kenë konfirmuar që kanë lexuar dhe pranuar Politikën e Privatësisë, ose duke përdorur automjetin në dijeni për përpunimin e të dhënave.

Perfaqesuesi i Kontrolluesit të të Dhenave në Shqipëri:

Porsche Albania Sh.p.k
Autostrada Tirane-Durres
Km. 3, Tirane,1051
dataprotection@porsche.al

II. Belgium

We are legally obliged to publish mileages (km) of networked vehicles at regular intervals (usually once every quarter) on request from Car-Pass vzw. The data is retained by Car-Pass vzw in a "Car-Pass" so that relevant information about a vehicle can be provided to potential purchasers when buying and selling used cars.

Personal data processed: Vehicle identification number (VIN), mileage (km), time of data collection in the vehicle

Legal basis: Article (6)(1)(c) GDPR in conjunction with Art. 6 Act of 11 June 2004 and Article 3/1, § 2 Royal Decree of 26 August 2006

Recipients: Car-Pass vzw, Woluwedal 46/2, 1200 BRUSSELS, BELGIUM; D'leteren Automotive SA /NV, Leuvensesteenweg 639, 3071 KORTENBERG, BELGIUM; CARIAD SE, Major-Hirst-Straße 7, 38442 WOLFSBURG, GERMANY; Audi AG, Auto-Union-Straße 1, 85057 INGOLSTADT, GERMANY (all recipients with the exception of Car-Pass vzw process data solely on our behalf and in accordance with our instructions)

III. Bosnia and Herzegovina

In deviation from the legal bases described in Part I the legal bases for processing personal data under the law of Bosnia and Herzegovina is a consent given by the data subjects. The consent of the data subjects is given either by registering for the mobile online services, after they have confirmed that they have read and accepted the Privacy Policy, or by using the vehicle in knowledge of the data processing.

Data controller representative in Bosnia and Herzegovina:

PORSCHE BOSNA I HERCEGOVINA
Porsche BH d.o.o. Sarajevo
Porsche Inter Auto BH d.o.o. Sarajevo
BIH-71000 SARAJEVO | Bulevar Meše Selimovića 16
zastita.podataka@porschebh.ba

IV. Japan

Personal information obtained from residents in Japan ("Personal Data") shall be handled in accordance with the following rules in addition to the rules set forth in Part I of this Privacy Policy.

1. Purpose: We will handle the Personal Data in accordance with the Purposes set forth in Part I of this Privacy Policy ("Purposes"), and not use Personal Data for any purpose other than such Purposes. We shall promptly notify the relevant data subjects, or disclose to the public of the Purposes (and any subsequent changes thereof), unless the Purposes have already been disclosed to the public;

2. Collection: We will not obtain any Personal Data through any deceptive, fraudulent, or other wrongful means;

3. Accuracy: We will make reasonable efforts to ensure that Personal Data handled by us is accurate and up to date and within the scope necessary to achieve the Purposes;

4. Retention: We will retain Personal Data in accordance with Section A.IV of Part I, and cease retention as soon as it is reasonable to assume that the Purposes are no longer being served by retention of Personal Data;

5. Protection: We will protect Personal Data in its possession or under its control by making reasonable security arrangements to prevent unauthorized access, collection, use, disclosure, copying, modification, disposal, damage, loss or similar risks. We will adequately supervise processing of Personal Data by our officers, employees, third party vendors and any other parties who process Personal Data on our behalf;

6. Transfer: Without obtaining the prior consent of the relevant data subjects, we will not transfer or provide any part of Personal Data to any individual or entity unless an exception under the APPI applies.

7. Extraterritorial Transfer: Without obtaining the prior consent of the relevant data subjects, we will not transfer or provide any part of Personal Data to any individual or entity located outside Japan, European Union or the United Kingdom unless (a) a transferee is located in a country or area certified by the Personal Information Protection Commission of Japan ("PPC") as having data protection standards equivalent to those of Japan or (b) the transferee has data protection standards equivalent to the standards specified by the PPC; and,

8. Data Subject's Right: If a data subject requests pursuant to the APPI disclosure of Purposes, access to, correction, or deletion of any of Personal Data relevant to such data subject, or lodge a complaint, we will respond to such request or complaint promptly and in accordance with the APPI. Any fee charged to data subjects shall be reasonable.

V. Switzerland

To the extent data processing falls within the scope of the Swiss Federal Act on Data Protection (FADP), (a) the scope of "personal data" shall be determined in accordance with the FADP, and (b) references to the GDPR shall be understood as references to the FADP.

To the extent that the transfer of personal data to recipients outside the EU respectively outside of Switzerland ("third countries") is safeguarded by the conclusion of standard contractual clauses approved by the European Commission, please note the decision of the Federal Data Protection and Information Commissioner to recognize the EU standard contractual clauses, which is available via the URL https://www.edoeb.admin.ch/edoeb/de/home/datenschutz/arbeit_wirtschaft/datenuebermittlung_ausland.html.

VI. San Marino

To the extent the data processing falls within the scope of the data protection laws of San Marino, pursuant to Article 13(1)(f) of San Marinese Law n. 171 of 2018, we specify that, considering the data controller's intention to transfer personal data to third countries or international organisations, the following means by which to obtain a copy of the appropriate or suitable safeguards used or information on where they have been made available are provided:

- You can contact us for exercising your rights, including the right to access your data and to obtain a copy of them, via the contact details provided in Part I ("Data protection officer").
- The EU standard contractual clauses used can be accessed in EU languages at <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/it/TXT/?uri=CELEX%3A32021D0914>.

To the extent the data processing falls within the scope of the data protection laws of San Marino, pursuant to Article 13(2)(d) of San Marinese Law n. 171 of 2018, we specify that the data subject has the right to report or to lodge a complaint with the Data Protection Authority of San Marino (<https://www.garanteprivacy.sm>).

VII. France

In addition to the rights listed in the section "Your rights" you also have the right to define directives concerning the fate of your personal data after your death (post-mortem right).

Pjesa III

Mbledhja e të dhënave për krijimin e një baze të dhënash anonime për zhvillimin e drejtimit të automatizuar (e disponueshme në varësi të modelit dhe pajimit)

I. Kontrolluesi

Me këtë politikë privatësie informojmë lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale përmes

Volkswagen AG
Berliner Ring 2
38440 Wolfsburg
Gjermani
kundenbetreuung@volkswagen.de

të regjistruar në regjistrin tregtar të gjykatës së rrethit Braunschweig, me nr. HRB 100484 ("Volkswagen AG"), gjatë aktivizimit të dërgimit të të dhënave për krijimin e një baze të dhënash anonime për kërkimin dhe zhvillimin e udhëtimit të automatizuar.

II. Përpunimi i detajuar i të dhënave

Funksioni i ngarkimit shërben për mbledhjen e datave matëse nga sensorët e automjetit. Këto të dhëna matëse transmetohen në serverin e të dhënave (shih më lart, A.VII.1. serveri i të dhënave), të anonimizuara menjëherë, dhe përdoren nga Volkswagen dhe partnerët bashkëpunëtorë për kërkimin dhe zhvillimin e drejtimit të automatizuar.

Të dhënat matëse përbëhen nga dy grupe të dhënash:

a. Të dhënat që janë të rëndësishme për rindërtimin e ndikimeve në automjet:

• Pozicioni dhe vula e orës së automjetit:

- Pozicioni i automjetit
- Ora e matjes
- Të dhënat përkatëse të lëvizjes (p.sh. rrotullimi i rrotave, këndi i timonit, shpejtësia dhe përshpejtimi i automjetit)
- Të dhënat e motorit që kanë rëndësi për lëvizjen e automjetit (p.sh. momenti rrotulluesi i motorit, numri i xhirove, ndërhyrjet e frenimit)

• mbledhja e të dhënave të mjedisit përreth përmes sensorëve të mëposhtëm:

- Sensorët e kamerave (p.sh. tabelat e identifikuar, gjurmët, objektet statike dhe dinamike (por jo të dhëna imazhesh apo videosh))
- Sensorët radarë (p.sh. reflektimet statike të objekteve, objektet dinamike të identifikuar)
- Sensorët me ultra tinguj (p.sh. distanca anësore nga objektet në mjedisin përreth)
- Klima, reshjet, drita (p.sh. temperatura, niveli i reshjeve, intensiteti i dritës)

• situatat e identifikuar të trafikut:

- Pikat lokale të rrezikut (p.sh. bllokim trafiku, aksidente, avari)
- Gjendja e rrugëve (p.sh. koeficienti i fërkimit, kursi i rrugës)

b. Të dhënat që janë të rëndësishme për të përcaktuar komandimin e preferuar nga drejtuesi i mjetit:

• sjellja e identifikuar e drejtuesit të mjetit:

- Lëvizjet e komandimit të drejtuesit të mjetit (p.sh. lëvizjet e timonit, frenat, gazi)
- Përdorimi i sistemeve të automjetit që ndikojnë në lëvizjen në udhëtim (p.sh. fikja/ndezja, përdorimi i sistemeve të asistencës për drejtuesin e mjetit, përdorimi i sistemeve të sigurisë)
- Gjendjet dhe ndërhyrjet e funksioneve që mbështesin drejtimin (p.sh. ndërhyrjet në sistemin e rregullimit të shpejtësisë, aktivizimi i frenimit të emergjencës, asistenti i drejtimit në parkim)

Do të mblidhen vetëm të dhënat e nevojshme për kërkimin dhe zhvillimin e funksioneve që janë të nevojshme për udhëtimin pjesërisht ose plotësisht automatik. Të dhënat matëse të anonimizuara vihen edhe në dispozicion të partnerëve të bashkëpunimit të Volkswagen, të cilët i përdorin edhe për kërkimin dhe zhvillimin e drejtimit të automatizuar, në bazë të parimeve kontraktuale që përfshijnë garancitë e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave.

Në bazë të këtyre të dhënave, do të krijohet një mjedis simulimi që mundëson testimin e funksioneve të automatizuara në të ardhmen në kushte realiste dhe i krahason rezultatet me sjelljen e dëshiruar të shoferit. Duke qenë se për garantimin e udhëtimit të automatizuar nevojiten disa miliardë kilometra testim, është e nevojshme që këto baza të dhënash të plotësohen me të dhëna reale. Vetëm kështu mund të mbledhur mjaftueshëm gjithë variantet e situatave të trafikut, për të garantuar që funksionet e ardhshme të drejtimit automatik të jenë mjaftueshëm të qëndrueshme dhe të sigurt, për të marrë gjithmonë vendime të sakta dhe për të mbrojtur sigurinë e personave që ndodhen në automjet.

Të dhënat e transmetuara pas krijimit të bazës së të dhënave, kontrollohen për cilësinë e më pas anonimizohen menjëherë në serverët e të dhënave. Të dhënat do të ruhen aty maksimumi njëzet e katër (24) orë, me qëllim anonimizimin dhe garantimin e cilësisë. Së fundi, të dhënat origjinale

fshihen plotësisht nga automjeti. Procesi i anonimizimit kontrollon dhe zhvillohet më tej në vazhdimësi për sa i përket efikasitetit, duke marrë parasysh zbulimet aktuale shkencore dhe ato më të fundit.

III. Baza ligjore dhe interesi legjitim

Dhënia e pëlqimit për përcjelljen e të dhënave nga automjeti, balancimi i interesave (neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR) për ruajtjen e të dhënave të përcjella deri në anonimizim.

Objektivat e lartpërmendur për kërkimin, zhvillimin dhe ruajtjen e funksioneve të automatizuara mund të arrihen vetëm me një bazë të dhënash domethënëse me një gamë të gjerë skenarësh të mundshëm trafik, në bazë të udhëtimit reale. Testet klasike të drejtimit për lëvizje rezistence nuk mjaftojnë më në këtë pikë. Të dhënat duhet të përbëhen mundësisht nga skenarë të ndryshëm drejtimi, nga ku mund të kapen situatat e trafikut përmes algoritmeve vetëm në qarkullimin rrugor real. Edhe blerja e të dhënave nuk është e mjaftueshme në këtë pikë, pasi të dhënat nuk janë të disponueshme në cilësinë e kërkuar dhe e humbasin vlefshmërinë pas pak kohe. Për këto arsye, Volkswagen ka një interes legjitim në përpunimin e të dhënave dhe krijimin e një baze të dhënash anonime.

IV. Fillimi dhe kohëzgjatja e mbledhjes së të dhënave

Transmetimi i të dhënave nuk është i aktivizuar nga fabrika por fillon vetëm me regjistrimin e një përdoruesi kryesor aktiv "We Connect" / "VW Connect" në automjet, nëse ky ka dhënë një pëlqim për përcjelljen e të dhënave nga automjeti. Këtë pëlqim, përdoruesi i regjistruar mund ta japë në portalin "MyVolkswagen" dhe ta tërheqë atë përsëri më vonë atje në rast nevojë. Përpunimi i të dhënave personale për qëllimin e anonimizimit të ardhshëm kryhet duke u bazuar në bazën ligjore të balancimit të interesave (neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR). Mbledhja e të dhënave është aktive vetëm në nivelet "Përdor pozicionin tim" dhe "Ndaj pozicionin tim". Në varësi të pajimit nëpërmjet përdorimit të rregullatorit me shtytje "Zhvillimi i udhëtimit të automatizuar" mund të aktivizohet ose çaktivizohet ngarkimi i të dhënave në automjet, në fushën e cilësimeve të privatësisë, si rrjedhojë, dhënia e pëlqimit nuk tërhiqet.

V. Marrësit e të dhënave

1. Serveri i të dhënave

Të dhënat përpunohen në serverët e ofruesve të mëposhtëm të shërbimeve, vetëm për llogarinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona:

CARIAD SE
Major-Hirst-Straße 7
38442 Wolfsburg
Gjermani

Audi AG
Auto-Union-Straße 1
85057 Ingolstadt
Gjermani

Microsoft Ireland Operations Limited
One Microsoft Place
South County Business Park
Leopardstown

Dublin 18
D18 P521
Irlandë

Në Microsoft të dhënat do të enkriptohen në bazë të marrëveshjeve me ne dhe do të përpunohen vetëm në serverët e të dhënave në Bashkimin Evropian. Duke qenë se Microsoft e ka selinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk mund të përjashtohet qasja (për lexim) e të dhënave nga SHBA-ja. Për transferimin e të dhënave personale tek përpunuesit e kërkesave në vendet e treta janë vendosur klauzolat përkatëse standarde kontraktuale të BE-së, për të mundësuar mbrojtje të mjaftueshme për të dhënat tuaja personale. Klauzolat standarde kontraktuale të përdorura të BE mund të hapen në faqen e internetit të Komisionit Evropian, në adresën e URL: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32021D0914>.

2. Ofruesi i shërbimeve IT

Ne përdorim gjithashtu ofrues të shërbimeve të ndryshme IT. Ata na mbështetin, për shembull, me mirëmbajtjen e sistemeve tona IT dhe me asistencë teknike. Për aq kohë sa ofruesit marrin akses për shërbimet e të dhënave personale, ata i përpunojnë ato vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona. Asistenca për IT ofrohet nga ofruesit e mëposhtëm të shërbimeve:

Volkswagen Group Service
Bunsenstrasse 5
85053 Ingolstadt
Gjermani

diconium digital solutions GmbH
Rommelstrasse 11
70376 Stuttgart
Gjermani

Volkswagen Infotainment GmbH
Rensingstrasse 15
44807 Bochum
Gjermani

VI. Të drejtat tuaja

Ju mund të kërkonti të drejtat e mëposhtme nga Volkswagen AG në çdo kohë dhe falas. Kjo vlen edhe për faktin se së bashku me kompani të tjera jemi përgjegjës për përpunimin e të dhënave. Më shumë informacione për mbrojtjen e të drejtave tuaja gjeni në faqen e internetit <https://datenschutz.volkswagen.de/>.

1. E drejta e informimit

Ju keni të drejtën të kërkonti nga ne një konfirmim nëse do të përpunohen të dhënat personale dhe – në rast se po – cilat prej tyre dhe cilave palë të treta brenda dhe jashtë BE-së do t'u përcillen të dhënat tuaja. Keni gjithashtu të drejtën të merrni nga ne një kopje të të dhënave tuaja personale të përpunuara prej nesh.

2. E drejta e korrigjimit

Ju keni të drejtën të kërkonti nga ne korrigjimin e të dhënave tuaja personale nëse janë të pasakta ose të paplota.

3. E drejta për fshirje

Ju keni të drejtën të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja, nëse përmbushen kushtet e përmendura në nenin 17 të GDPR. Më pas, ju keni të drejtën, për shembull, të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja, për atë kohë sa ato nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur. Përveç kësaj, mund të kërkonti fshirjen, nëse të dhënat tuaja i përpunojmë në bazë të dhënies së pëlqimit tuaj dhe ju e revokoni këtë pëlqim.

4. E drejta për kufizimin e përpunimit

Ju keni të drejtën të kërkonti kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja, nëse përmbushen kushtet e nenit 18 të GDPR. Ky për shembull është rasti, nëse kundërshtoni saktësinë e të dhënave tuaja. Për kohëzgjatjen e verifikimit të saktësisë së të dhënave, mund të kërkonti më pas kufizimin e përpunimit.

5. E DREJTA E REFUZIMIT

Ju keni të drejtën të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale në rastet e mëposhtme:

- **Nëse përpunimi bëhet për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë (duke përfshirë profilizimin për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë).**
- **Nëse përpunimi (duke përfshirë profilizimin) mbështetet në bazat e mëposhtme ligjore:**
 - **Përpunimi është i nevojshëm për zbatimin e një procesi që ka interes publik ose për ushtrimin e autoritetit publik që na është ngarkuar (neni 6, paragrafi 1, germa "e" e GDPR).**
 - **Përpunimi është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave legjitime nga ne ose palë e tretë (neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR). Në rastin e një kundërshtie të tillë, ju lutemi të ndani me ne arsyet, për të cilat kundërshtoni përpunimin e të dhënave. Ne nuk i përpunojmë më të dhënat tuaja në rastin e kundërshtimit tuaj, në qoftë se ne mund të tregojmë arsyet detyruese mbrojtëse për përpunimin, të cilat tejkalojnë interesat, të drejtat dhe liritë tuaja, ose nëse përpunimi i shërben zbatimit, ushtrimit ose mbrojtjes së pretendimeve ligjore.**

6. E drejta për transmetimin e të dhënave

Nëse përpunimi i të dhënave bazohet në dhënien e pëlqimit tuaj ose në zbatimin e një kontrate dhe nëse kjo bëhet përmes një metode përpunimi të automatizuar, atëherë ju keni të drejtën t'i merrni të dhënat tuaja në një format të strukturuar, të zakonshëm dhe të lexueshëm nga pajisjet kompjuterike, si dhe t'ia transferoni ato një organi tjetër përgjegjës. Përveç kësaj, keni të drejtën të kërkonti që të dhënat personale të transferohen direkt nga ne në një organ tjetër përgjegjës.

7. E drejta e revokimit

Nëse përpunimi i të dhënave bazohet në dhënien e pëlqimit, ju keni të drejtën ta tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo moment pa pagesë, me efekt në të ardhmen, përmes emailit tek info-datenschutz@volkswagen.de (Gjermani), privacy@volkswagen.de (jashtë Gjermanisë), përmes portalit tonë të mbrojtjes së të dhënave të Volkswagen <https://www.datenschutz.volkswagen.de> ose duke kontaktuar në të dhënat e kontaktit tek "Të dhënat e botimit".

Përveç kësaj, ju mund ta revokoni në çdo kohë pëlqimin tuaj në llogarinë tuaj të përdoruesit Volkswagen ID në "MyVolkswagen".

8. E drejta e ankimit

Ju keni gjithashtu të drejtë të paraqisni një ankesë pranë autoriteteve mbikëqyrëse (p.sh. pranë Zyrtarit të shtetit për përpunimin e të dhënave në Niedersachsen ose pranë autoriteteve mbikëqyrëse përgjegjëse për vendbanimin tuaj) lidhur me përpunimin që ne u bëjmë të dhënave tuaja.

VII. Pika juaj e kontaktit

1. Pika e kontaktit për ushtrimin e të dhënave tuaja

Personi i kontaktit për ushtrimin e të drejtave tuaja dhe informacione të mëtejshme i gjeni në faqen e mëposhtme të internetit <https://datenschutz.volkswagen.de/>.

2. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave

Përgjegjësi ynë për mbrojtjen e të dhënave është pika e kontaktit në dispozicionin tuaj për çështje që lidhen me mbrojtjen e të dhënave:

Datenschutzbeauftragter der Volkswagen AG
Berliner Ring 2
38440 Wolfsburg
Gjermani
dataprivacy@volkswagen.de